

Arben Ahmetaj njollos fitoren e PS, rezultat negativ në Kavajë

Ndërkohë që PS-ja rritet në të gjithë vendin, në zonën e ish-ministrit të Financave shënoi një rënie 7.67%. Vetëm këtu rritet PD-ja



NE KAVAJE PS RREZIKON BASHKINE, LUFTE DERI NE VOTEN E FUNDIT

Dorjan Murati i PS-së dhe Isa Sakja i PD-së janë shumë pranë. Fituesi do përcaktohet në kutinë e fundit ▶ FAQE 7



[SHQIPTARJA.com]

Lexoni
Dëgjoni
Shikoni
EDICIONI MULTIMEDIAL



Kjo gazetë përdor teknologjinë QR-CODE

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VII - NR. 150

E MËRKURË, 28-06-2017

www.shqiptarja.com

Plas lufta në PD

NJEREZIT E BERISHES KERKOJNE LARGIMIN E LULZIM BASHES

Mbi 80 figura të PD-së petition për dorëheqjen e kryetarit. Argita Berisha kandidate e mundshme për të marrë drejtimin e partisë. Reagon Basha: Nuk iki, hap garën brenda PD, ngrij funksionet si kryetar

▶ FAQE 2-3



**RULI-DEMOKRATEVE:
NXIRRENI BASHEN
NGA SELIA ME
GRUAN DHE KUNATIN**



**JOZEFINA TOPALLI
THIRRJE PER
RREZIMIN E BASHES
ME PROTESTA**



**BREGU-BASHES:
JE DOREHEQJEN
PER KATASTROFEN
E PAMERITUAR**

REZULTATET ZYRTARE

▶ FAQE 5, 8-22

MBYLLET NUMERIMI, KQZ: PS 74 MANDATE, PD 43, LSI 19, PDIU 3

Tabelat e plota me rezultatet në rang kombëtar dhe në të 12 qarqet. Parlamenti i ri, ja deputetët që dalin nga Zgjedhjet. PDIU pretendon mandatin e humbur, Doda: Ka gabim teknik. Rama: Populli foli troç, PS qeverisëse e vendit



SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



Nisma
Nismës i janë bashkuar edhe dhëndri i Berishës, Jamarbër Malltezi, Avenir Peka, Gjergj Lezhja, Suzana Guxholli etj., të njohur si të besuar të Sali Berishës. Personazhe të tillë nënkuptojnë se nisma mund të ketë mbështetjen e Berishës.

HUMBJA E ZGJEDHJEVE

Njerëzit e Berishës kërkojnë largimin e Bashës

Argita Berisha kandidate e mundshme për të marrë drejtimin e PD-së



ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Ishite e pashmangshme. Pozitat e Lulzim Bashës në krye të PD janë më të rrezikuara se kurrë më parë. Në Partinë Demokratike ka nisur lufta për largimin e tij. Disfata katastrofike e Partisë Demokratike, në drejtimin e Lulzim Bashës, në zgjedhjet e 25 Qershorit 2017, ka rebeluar rrethin e Sali Berishës, të cilët kanë kërkuar dje dorëheqjen e Bashës, si përgjegjës për humbjen në zgjedhje si dhe për përçarjen e partisë. Ende pa u numëruar kutitë e fundit, Lulzim Basha ka marrë dje goditjen e parë nga brenda partisë, pikërisht nga të besuarit e Sali Berishës, njeriut që e vendosi Bashën katër vite më parë në krye të partisë. Mbi 80 figura të Partisë Demokratike kanë firmosur dy peticione, me anë të të cilëve kërkuar largimin e Lulzim Bashës. Nismës i janë bashkuar edhe dhëndri i Sali Berishës, Jamarbër Malltezi, Avenir Peka, Gjergj Lezhja, Suzana Guxholli etj., të njohur si të besuar të Berishës. Personazhe të tillë nënkuptojnë se nisma mund të ketë mbështetjen e ish-kryeministrit, partia e të cilit po rrudhet në çdo palë zgjedhje. Ndërkaq, një nga kandidaturat e mundshme për të zëvendësuar Lulzim Bashën mund të jetë edhe Argita Berisha, vajza e Sali Berishës. Ndonëse Basha deklaroi mbremë se do të rikandidojë sërish për t'u rikonfirmuar për një mandat të dytë në krye të PD, qëndrimi i Berishës do të jetë përcaktues për fatin e tij si dhe për mundësinë e kandidimit të Argitës, për të marrë drejtimin e PD.



→ **DISFATA**

Disfata katastrofike e PD, në drejtimin e Lulzim Bashës, në zgjedhjet e 25 Qershorit 2017, ka rebeluar rrethin e Sali Berishës, të cilët kanë kërkuar dje dorëheqjen e Bashës.

mos nga 19 eksponentë të PD, ndërsa më vonë doli edhe një listë me dhjetëra figura të kësaj partie. Peticioni i dytë është firmosur nga Majlinda Bregu,

Genc Ruli, Ridvan Bode, Astrit Patozi, Keltis Kruja, Dashnor Sula, Shaban Memia etj. Të dy palët kanë identifikuar Bashën si përgjegjës kryesor për humbjen. "Tani që përfundoi numërimi i çdo kutie të këtij procesi zgjedhor të vështirë dhe të ndotur nga paratë e pista të drogës dhe kërcënimeve të papranueshme për një shoqëri të lirë, dëshirojmë që në radhë të parë të falënderojmë komisionerët dhe numëruesit e PD që kanë qenë heronj, dinjitozë dhe qëndrestarë në këto momente të vështira për PD dhe procesin zgjedhor. Humbja e thellë e PD në këto zgjedhje na detyron marrjen përsipër të përgjegjësisë. Lulzim Basha kryetari i PD është përgjegjës kryesor i kësaj humbjeje", thuhet në peticionin e grupit të parë.

AKUZAT

Përfaqësuesit e Partisë Demokratike kanë akuzuar Lulzim Bashën se me anë të manovrave statutore bëri një listë personale. "Për më tepër Kryetari i Partisë ka marrë përsipër personal-

POSTERI



'Basha ik' në murin e selisë së PD

Një poster "Basha ik" është vendosur parje në mbrëmje në murin kryesor, në hyrje të selisë së Partisë Demokratike në Tiranë. Nuk dihet se kush janë autorët e këtij veprimi që çon një mesazh të drejtpërdrejt dhe të fortë te kryetari i PD. Militantët janë mjaft të irrituar me këtë humbje dërmuese të PD e cila ka prekur kufirin e 43 mandateve në Kuvendin e ardhshëm, si asnjëherë më parë në histori.

isht, në shkelje të normave statutore hartimin e listës së deputetëve dhe programin e fushatës, duke hequr përdhunshëm simbolet e PD dhe

mbjellë përçarje të pamerituar me etiketimet "ky është i republikës së vjetër deri tek 22-vjeçarët e FRPD. Basha bëri një fushatë për Listën

Basha duke mos reflektuar asnjë nga shqetësimet dhe kauzat kryesore të opozitës si kriminalizimi i parlamentit dhe administratës, droga, koncesionet etj dhe në përputhje të plotë me fushatën e PS. Prandaj, Kryetari i PD Lulzim Basha si përgjegjës i kësaj humbjeje duhet të japë dorëheqjen për t'i hapur rrugë rinovimit të PD dhe bashkimit sa më të gjerë të saj!", thuhet në peticion.

LISTA E DYTË

Edhe firmëtarët e peticionit të dytë, kërkojnë largimin e Lulzim Bashës nga PD. "Kërkojmë Dorëheqjen e menjëhershme dhe të përvokueshme të kryetarit, Lulzim Basha, si përgjegjës i vetëm për humbjen e paprecedent dhe dramatike të PD në këto zgjedhje si dhe për dështimet e njëpasnjëshme elektorale gjatë mandatit të tij. Fillimin e një procesi të analizës dhe reflektimit serioz e të përgjegjshëm për rindërtimin e shpejtë të PD, si hap i parë për ringritjen e të djathtës në Shqipëri", thuhet në peticion.

LISTA E DYTË ME FIRMËTARËT QË KËRKOJNË LARGIMIN E BASHËS

| | | | | | | | |
|--------------------|--------------------|-----------------------|---------------------|----------------------|-------------------|----------------------|----------------------|
| 1. Besnik Mustafaj | 10. Ardian Kollozi | 19. Shrefedin Shehu | 28. Shaban Memia | 37. Edi Vecani | 46. Artur Ajazi | 54. Bedri Mihaj | 62. Aurel Agolli |
| 2. Majlinda Bregu | 11. Rajmond Hoxha | 20. Fabian Topollaj | 29. Arqile Gorea | 38. Vilson Haxhiraj | 47. Edlira Jakova | 55. Florian Dani | 63. Ilir Kondi |
| 3. Genc Ruli | 12. Eleina Qirici | 21. Grigel Muscollari | 30. Artur Shehu | 39. Agron Hasanbasha | 48. Renato Preza | 56. Vasillaq Ngresi | 64. Ndue Paluca |
| 4. Ridvan Bode | 13. Gjergji Papa | 22. Arieta Keci | 31. Vasillaq Ndreko | 40. Mirela Mucaj | 49. Koco Bello | 57. Nexhmi Dokollari | 65. Guri Tatari |
| 5. Armand Teliti | 14. Bedri Hoxha | 23. Andi Permeti | 32. Ermira Qosja | 41. Remzi Haxhiu | 50. Valter Miza | 58. Ermir Petriti | 66. Ilir Krosi |
| 6. Astrit Patozi | 15. Roland Keta | 24. Kozma Dashi | 33. Luter Nuraj | 42. Bedri Luku | 51. Ramadan Hoxha | 59. Demir Gjana | 67. Kristo Cipa |
| 7. Keltis Kruja | 16. Kreshnik Bozho | 25. Ferdinand Shehu | 34. Atird Hoxha | 43. Iriat Hyka | 52. Genci Doci | 60. Spartak Shaholli | 68. Nexhnie Xhuveli |
| 8. Agron Musaraj | 17. Gent Minarolli | 26. Roland Keta | 35. Viktor Bezhani | 44. Mirela Hasanaj | 53. Ilir Laci | 61. Armand Cenolli | 69. Vasil Milo Rrapo |
| 9. Igli Cara | 18. Mirgen Lata | 27. Dashnor Sula | 36. Gjovalin Bzheta | | | | |

PETICIONI

Të shqetësuar:

-Për rezultatin katastrofik të PD në këto zgjedhje;
-Për thellimin e dobësisë të kapaciteteve konkurruese elektorale dhe organizative të PD;
-Për shkeljet e rënda dhe nëpërkëmbjet statutore 4 vjeçare;
-Për kërcënimin e identitetit tonë si demokrate nga goditjet sistematike të

qëllimshme e kompleksive të simboleve të PD;

-Për mospërfilljen e vazhdueshme të forumeve vendimmarrëse të PD-së;
-Për mungesën e një perspektive të afërt, të qartë, shpresëdhënëse për demokratët;
-Të ndërgjegjshëm për peshën e rëndë të misionit opozitar përballë maxhorancës të pamerituar dhe të pakontrolluar të Edi Ramë-s e cila u mundësua nga sjellja e papërgjegjshme dhe pazaret okulte politike të Lulzim Bashës;

Të ndodhur në një situatë të paprecedent të rënies së rezultateve elektorale të PD-së gjatë kohës së qenies në opozitë dhe të precedentit të zbatuar në PD nga Kryetari i Partisë, për raste të tilla;

Kërkojmë:

1. Dorëheqjen e menjëhershme dhe të përvokueshme të Kryetarit, Lulzim Basha, si përgjegjës i vetëm për humbjen e paprecedent dhe dramatike të PD në këto zgjedhje si dhe për dështimet e njëpasnjëshme elektorale

gjatë mandatit të tij.

2. Fillimin e një procesi të analizës dhe reflektimit serioz e të përgjegjshëm për rindërtimin e shpejtë të PD, si hap i parë për ringritjen e të djathtës në Shqipëri.

3. Zhvillimin e një procesi zgjedhor gjithëpërfshirës dhe me garanci të plota statutore dhe të çliruar nga çdo ndikim i hapur ose i fshehtë. I bëjmë thirrje çdo demokrate që t'i bashkëngjitet listës së hapur që shoqëron këtë qëndrim.




RULI-DEMOKRATËVE: NXIRRENI BASHËN NGA SELIA BASHKË ME GRUAN DHE KUNATIN

Pas deklaratës së Lulzim Bashës, i cili paralajmëroi se do të rikandidohej, ka reaguar ashpër Genc Ruli. Ish-ministri i Ekonomisë u ka bërë thirrje demokratëve që ta përzënë Bashën nga selia bashkë me gruan dhe kunatin, Erjon Isufi. "Basha me deklaratën e tij justifikuese e banale tregoi që dinjiteti personal është gjëja më e fundit që e shqetëson atë. Normalisht për një individ që e mori "leadershipin" e PD si dhuratë në "paje" nga Berisha dhe që i bëri programet e listat jo me zyrtarët e PD, por me gruan e kunatin. Ju them atyre që ende e duan PD, e jo që ende ju duhet, n.q.s ai nuk jep dorëheqjen vetë deri nesër, shkoni te selia e PD e përzieni atë, gruan e kunatin siç përzuri Jezusi tregtarët nga Tempulli", ka pohuar Ruli.



JOZEFINA TOPALLI BËN THIRRJE PËR RRËZIMIN E BASHËS ME PROTESTA

Ish-nënkryetarja e PD, Jozefina Topalli ka shpërthyer kundër Lulzim Bashës, pas deklaratës së këtij të fundit. Ajo bëri thirrje që demokratët të marrin fatin në dorë qoftë kjo dhe me protesta. "Në një kohë dramatike për Partinë Demokratike, pas një humbje katastrofale personale të Lulzim Bashës, ka një emergjencë për demokratët. Partisë Demokratike duhet me i dal zot. Në një situatë si kjo, kur Lulzim Basha nuk pranon të marrë as përgjegjësinë që i takon, siç ndodh në çdo vend të botës perëndimore, (pasi e çoi buzë gremine PD), reagimi i tij është hileqar, tallje, tinëzi, banalitet dhe papërgjegjshmëri e frikshme që mund të çojë në asgjësimin total të PD. Në këto kushte, nëse Basha nuk jep dorëheqjen e përvokueshme, demokratët duhet të marrin fatin në dorë, me protesta dhe forma të ndryshme demokratike, me synim kthimin e PD-së demokratëve", shkruan Topalli.



BREGU-BASHËS: JEP DORËHEQJEN PËR KATASTROFËN E PAMERITUAR

Shtohet presioni mbi Lulzim Bashën për të dhënë dorëheqjen. Ish-ministria Integritetit, Majlinda Bregu i ka kërkuar mbërë Bashës që të largohet për katastrofën e pamertuar për demokratët. "Folën shqiptarët me 25 Qershor! Demokratët thirren edhe më fort me mungesën e tyre! 190 mijë vota minus! Lulzim Basha belbëzoi lëmekur "ngrirjen" e tij duke ua lënë fajin të tjerëve! I doli për Zot standardit të zgjedhjeve me përfshirjen e ministrave në qeveri! I doli për Zot kontrollit e drejtimit të ndërmarrjeve me buxhet financiar për "të mbyllur" rubinetin e përdorimit të parave publike në fushatë! I doli për Zot projektit të tij të Republikës së Re me premtimin se do ishte KM i saj! I doli për Zot mitingjeve dhe një fushatë pa shpirt, pa frymë duke e quajtur më të mirën e me masiven që kishte parë PD! Sot duhet t'i dilte për Zot, dorëheqjes se tij si përgjegjësi i vetëm për katastrofën e pamertuar në të cilën gjendet sot PD", tha Bregu.



LISTA E PARË ME FIRMËTARËT QË KËRKOJNË DORËHEQJEN E BASHËS

| | |
|----------------------|-----------------------|
| 1. Arben Skënderi | 11. Jamarbër Malltezi |
| 2. Avenir Peka | 12. Julian Deda |
| 3. Edith Harxhi | 13. Juela Meçani |
| 4. Edvin Kulluri | 14. Leonard Olli |
| 5. Endira Bushati | 15. Ledina Aliolli |
| 6. Avenir Peka | 16. Mirgen Lata |
| 7. Fabian Topollaj | 17. Valbona Mezini |
| 8. Gent Malko | 18. Suzana Guxholli |
| 9. Grigels Muçollari | 19. Tomorr Alizoti |
| 10. Gjergj Lezhja | |

PETICIONI

Tani që përfundoi numërimi i çdo kutie të këtij procesi zgjedhor të vështirë dhe të ndotur nga paratë e pista të drogës dhe kërcënimeve të papranueshme për një shoqëri të lirë, dëshirojmë që në radhë të parë të falënderojmë komisionerët dhe numëruesit e PD që kanë qenë heronj, dinjitozë dhe qëndrestarë në këto momente të vështira për PD dhe procesin zgjedhor.

Humbja e thellë e PD në këto zgjedhje na detyron marrjen përsipër të përgjegjësisë. Lulzim Basha kryetari i PD është përgjegjësi kryesor i kësaj humbjeje.

Për më tepër Kryetari i Partisë ka marrë përsipër personalisht, në shkelje të normave statutore hartimin e listës së deputetëve dhe programin e fushatës, duke hequr përdhunshëm simbolet e PD dhe mbjellë përçarje të pamertuar me etiketimet "ky është i republikës së vjetër deri tek 22-vjeçarët e FRPD".

Basha bëri një fushatë për Listën Basha duke mos reflektuar asnjë nga shqetësimet dhe kauzat kryesore të opozitës si kriminalizimi i parlamentit dhe administratës, droga, cesionet etj dhe në përputhje të plotë me fushatën e PS.

Prandaj, Kryetari i PD Lulzim Basha si përgjegjësi i kësaj humbjeje duhet të japë dorëheqjen për t'i hapur rrugë rinovimit të PD dhe bashkimit sa më të gjerë të saj!

Lulzim Basha: Nuk iki, hap garën brenda PD-së

Basha u përgjigjet kundërshtarëve në PD, ngrin funksionet si kryetar, paralajmëron rikandidimin

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Nuk do t'i braktis demokratët. Kjo ishte përgjigja që Lulzim Basha u dha djekundërshtarëve të tij në Partinë Demokratike, të cilët i kërkuan të japë dorëheqjen si përgjegjësi kryesor për humbjen në zgjedhjet e 25 Qershorit. Lulzim Basha, në një dalje urgjente, tha se kishte vendosur që të ngrinte funksionet e tij si kryetar, ndërsa u kërkoi nënkryetarëve që të hapin garën për kreun e PD, duke paralajmëruar se do të rikandidojë. "Kam reflektuar thellë këto 3 ditë, marr përgjegjësitë për humbjen. Demokratët meritojnë ballafaqim të plotë mes atyre që luftuan për fitoren e PD dhe atyre që humbën karriget e ofiqet. Sa gabova nuk e përcaktoj dot unë, por nuk e bëjnë dot as ata që nuk punuan asnjë ditë për fitoren e PD. Për këtë arsye kam vendosur të ngrij funksionet e mia dhe t'ua delegoj ato dy nënkryetarëve për të organizuar garën brenda PD-së me votën një anëtar një votë. Unë kam një projekt dhe atë do e vlerësojnë demokratët. Gjëja më e thjeshtë është që të largohesha, por unë nuk do të iki ti braktis demokratët por do të luftoj deri në fund për ta dhe me ta", tha Basha.



BASHA

"Unë kam një projekt dhe atë do e vlerësojnë demokratët. Gjëja më e thjeshtë është që të largohesha, por unë nuk do të iki ti braktis demokratët por do të luftoj deri në fund për ta dhe me ta".

ZGJEDHJET

"Blerja e votës u bë masivisht, duke zhvlerësuar planin e demokratëve. Kjo ishte një garë e pabarabartë, por një garë ku unë nuk kam në mend të konkurroj me të njëjtat mjete".

"Blerja e votës u bë masivisht, duke zhvlerësuar planin e demokratëve. Kjo ishte një garë e pabarabartë, por një garë ku unë nuk kam në mend të konkurroj me të njëjtat mjete. Ajo që ndodhi me zgjedhjet e 25 qershorit është triumf i paligjshmërisë. Unë

e PD morëm një rezultat zhgënjyes, por shumë shqiptarë ishin në ofertë për votën, por të tjerë besuan në vlera e parime qytetarë drejt së cilave në aspirojmë të shkojmë. Vota që mori PD në 25 ishte e keqe. Mbi 450 mijë qytetarë refuzuan të votojnë. Unë e PD nuk jepemi, kjo është një luftë për jetë e vdekje. Kjo është një luftë që kemi ndër mend ta vazhdojmë deri në fitore. Sigurish nuk fus në një thes socialistët që mbështesin partitë e tyre. Nuk ka gjë më të trishtë se shitja e blerja e votës. Kjo mund të mbajë një parti në pushtet, por do e çojë vendin në një hon. Në këtë nuk do ta lejojmë, unë nuk do e lejoj. Qoftë dhe vetëm për këtë ia vlen të luftosh deri në fund. Mandatet për mazhorancën nuk kanë dalë nga qytetarët, por nga korridorët e errëta. Nuk ka gjë më të trishtë se blerja e votës", tha Basha.

PROJEKTI

Kreu i PD tha se projekti i tij ishte real. "Projekti që unë nisa lindi me qytetarët, i kam në mendjen time ata që takova nga jugu në veri. Jam bërë me ta, në momentet më të vështira, kur nuk ushqenin dot fëmijët, kur nuk paguanin dot taksat, kur humbnin të afërmin nga padrejtësia e shtetit etj. Qindra mijëra qytetarë, të rinj e të reja, shumicën e heshtur të këtij vendi që nisa një rrugëtim. Ata që iu përgjigjen thirrjes sime me protestën në çadër ku mori jetë ëndrra për Republikën e Re. Unë e di mirë që ata e dinin unë nuk mund të bëja mrekullitë, nuk më besuan ëndrrat e shpresat për kalkuzime për pushtet, e di dhe këtë", pohoi ai.

Pasi mori mandatin, Nard Ndoka mbron Bashën për humbjen

Pas marrjes së mandatit të deputetit në Shkodër, Nard Ndoka në një reagim në Facebook shprehet se opozita humbi një betejë që ishte e minuar, por ngritja dhe fitorja është e afërt dhe e sigurt. Pavarësisht humbjes së thellë, Ndoka deklaroi se Lulzim Basha i duhet opozitës u duhet demokratëve për të vazhduar luftën me të keqen. "Lulzim Basha i duhet opozitës; u duhet demokratëve për të vazhduar luftën me të keqen, për të vendosur standarde



kushtetuese për Kodin Zgjedhor, për Drejtësinë, për reformat dhe integrimin tonë evropian. Demokratët nuk kanë kohë për të humbur, as për të vajtuar, as për të dëgjuar kritikët inatçorë, që vetëm shajnë e kritikojnë. Personazhe pa alternativa, pa ide, por vetëm me mllef! Opozita ka një projekt, ka një alternativë, ka një shpresë, dhe ky është Lulzim Basha! Ne humbëm një betejë që ishte e minuar, por ngritja dhe fitorja jonë është e afërt dhe e sigurt", shkruan Ndoka.

Pollo analizon disfatën: Pse PD i humbi zgjedhjet



Genc Pollo, i renditur i dyti në listën e Partisë Demokratike në Qarkun e Fierit, ka analizuar humbjen e thellë. "Ishte një fushatë zgjedhore e shkurtër, madje tepër e shkurtër, veçanërisht intensive, e në mot të nxehtë. Do të përpiqem t'i përfaqësoj luajalisht në Kuvend e t'u jem pranë sa herë të lipset. Procesi zgjedhor fatkeqësisht sërish u cenua nga votëblerja masive përmes personave të PS e LSI, presioni i administratës shtetërore, me

gjithë përpjekjet e lavdërueshme të "ministrave teknikë", dhe në disa qarqe riaktivizim i grupeve kriminale në favor të PS. Megjithatë vota për PD fatkeqësisht nuk ishte ajo që shpresonim apo edhe prisnim. Ajo nuk na delegoi përgjegjësinë e pushtetit. Pas kësaj fillon procesi i ngritjes së PD si parti e përgjegjësisë të madhe në vendin tonë. Asnjë rrethanë a mazhorancë nuk është e pandryshueshme", shkruan Pollo në rrjetin social.

NË RANG KOMBËTAR



KQZ: Partia Socialiste 74 mandate, PD-ja 43, LSI-ja 19, PDIU 3, PSD 1

Votat në rang kombëtar, PS rritje me 6.7 %, PD-ja në rënie me 2.1 %, LSI rritje me 3.7 %



REZULTATET NE KOHE REALE
NE RANG KOMBETAR

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni
QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Partia Socialiste fiton zgjedhjet parlamentare të 25 Qershorit 2017 me një rezultat në kufijtë e të pabesueshme,

në raport me pritshmëritë e vetë drejtuesve të PS. Shqiptarët i kanë besuar Partisë Socialiste timonin e drejtimit të Shqipërisë deri në vitin 2021, duke lënë në opozitë Partinë Demokratike dhe Lëvizjen Socialiste për Integrim. Nga përfundimi i numërimit të 5363 kuti votimi, pasditen e djeshme, Partia Socialiste u zyrtarizua si fituesja e zgjedhjeve parlamentare me 48.33 % të votave, përthyer në mandate, 74 mandate, të mjaftueshme për të qeverisur e vetme vendin. PS rezultoi me një rritje me 6.7 % krahasuar me rezultatit në zgjedhjet parlamentare të 23 Qershorit 2013. Sipas rezultateve të KQZ, Partia Demokratike u rëndit e dyta teksa mori 43 mandate, ose ndryshe 455.481 vota, rreth 21.88 %.

Në 2013 Partia Demokratike mori 50 deputetë. Në zgjedhjet e 2017 PD mori 2.1 % vota më pak. Lëvizja Socialiste për Integrim, që këto zgjedhje u drejtua nga Petrit Vasili, mori 19 deputetë që përkthehen ndryshe në 225.678 vota. Në 2013 Lëvizja Socialiste për Integrim mori 16 mandate. LSI, në 2017, u rrit me 3.7 %. Në këto zgjedhje tre deputetë mundi t'i marrë edhe PDIU, e cila ka marrë 75.938 vota. Por, kryetari i s kësaj force politike Shpëtim Idrizi, që garonte në Tiranë, nuk ka mundur ta marrë mandatin. PS dhe PDIU luftuan për gati 24 orë në Tiranë për një mandat, mandat të cilin më në fund e mori PS, duke lënë Idrizin jashtë parlamentit të ri.

Ndërkohë në parlament do jetë edhe Partia Socialdemokrate, e cila ka marrë një deputet në Qarkun e Shkodrës, konkretisht ish deputeti socialist Tom Doshi. Ndërkaq, jashtë parlamentit kanë mbetur figura të rëndësishme të opozitës, si Agron Duka, Arben Ristani, Astrit Veliaj, Gerti Bogdani në Tiranë etj. Si asnjëherë më parë, Partia Socialiste ka dominuar në 10 qarqe të vendit nga 12 qarqe në total. Për herë të parë që pas zgjedhjeve të 1992, shqiptarët i kanë besuar PS të qeverisë vendin e vetme pa aleanca.

Rezultati
Nga përfundimi i numërimit të 5363 kuti votimi, pasditen e djeshme, Partia Socialiste u zyrtarizua si fituesja e zgjedhjeve parlamentare me 48.33 % të votave, përthyer në mandate, 74 mandate, të mjaftueshme për të qeverisur e vetme vendin.

Shpëtim Idrizi
Shpëtim Idrizi, që garonte në Tiranë, nuk ka mundur ta marrë mandatin. PS dhe PDIU luftuan për gati 24 orë në Tiranë për një mandat, mandat të cilin më në fund e mori PS, duke lënë Idrizin jashtë parlamentit të ri.

Të ndëshkuarit
Në parlament do jetë edhe Partia Socialdemokrate, e cila ka marrë një deputet në Qarkun e Shkodrës, konkretisht ish deputeti socialist Tom Doshi. Ndërkaq, jashtë mbetën Agron Duka, Arben Ristani, Astrit Veliaj, Gerti Bogdani në Tiranë etj.

PËRDITËSIMI I FUNDIT: 00:18

QV TË NUMËRUARA: 5354/5363

| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
|------|--------|---------|-------|-------|----------|------|
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 226,245 | 14.31 | 10.65 | 19 | 1 |
| | PS | 762,109 | 48.21 | 41.49 | 74 | 6 |
| | PKD | 3,795 | 0.24 | 0.43 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 3,550 | 0.22 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 4,306 | 0.27 | 3.13 | 0 | 0 |
| | PD | 453,421 | 28.68 | 30.81 | 43 | 3 |
| | PBDKSH | 1,723 | 0.11 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 758 | 0.05 | 0.05 | 0 | 0 |
| | PSD | 14,976 | 0.95 | 0.61 | 1 | 0 |
| | AD | 658 | 0.04 | 0.07 | 0 | 0 |
| | FRD | 5,135 | 0.32 | 1.74 | 0 | 0 |
| | PDS | 2,830 | 0.18 | 0.68 | 0 | 0 |
| | PDIU | 75,383 | 4.77 | 2.42 | 3 | 1 |
| | AAK | 392 | 0.02 | 0.22 | 0 | 0 |
| | MEGA | 2,226 | 0.14 | 0.13 | 0 | 0 |
| | PKSH | 1,038 | 0.07 | 0.05 | 0 | 0 |
| | APD | 1,580 | 0.1 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 20,744 | 1.31 | 0 | 0 | 0 |

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



Ahmetaj

Pas kësaj njolle në tablonë e fitores së Partisë Socialiste, në Qarkun e Tiranë, qëndron një emër konkret, emri i Arben Ahmetajt, i cili ka kontribuar për rritjen e Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim në Kavajë.

BILANCI

Arben Ahmetaj njollos fitoren e PS, rezultat negativ në Kavajë

Ndërkohë që PS-ja rritet në të gjithë vendin, në zonën e ish-ministrit të Financave shënoi një rënie 7.67%. Vetëm këtu rritet PD-ja

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Shkëlqimi i fitores historike, në kufijtë e të pabesueshmes, së Partisë Socialiste në Qarkun e Tiranës, zbehet nga një rezultat negativ në Kavajë, gjithnjë krahasuar me rezultatin e arritur në zgjedhjet parlamentare të 2013. Pas kësaj njolle në tablonë e fitores së Partisë Socialiste në Qarkun e Tiranë, qëndron një emër konkret, ai i Arben Ahmetajt, i cili ka kontribuar për ringritjen e Partisë Demokratike dhe rritjen e Lëvizjes Socialiste për Integrim në Kavajë. Kryeministri Edi Rama, drejtimin e fushatës në zonën kur në vitin 2011 u rrëzua miti i Sali Berishës, me një fitore spektakolare të Partisë Socialiste, ia besoi pikërisht Arben Ahmetajt, ministrit më të fuqishëm, madje ndër më të pasurit të kabinetit qeveritar.

REZULTATI I PS, PD DHE LSI NË KAVAJË DHE KRAHASIMI ME ZGJEDHJET E 2013

| | Partia Socialiste | | | Partia Demokratike | | | Lëvizja Socialiste për Integrim | | |
|-----------------------|-------------------|--------------|--------------|--------------------|--------------|--------------|---------------------------------|--------------|-------------|
| | VOTA E 2017 | 2013 | | VOTA E 2017 | 2013 | | VOTA E 2017 | 2013 | |
| Bashkia Kavajë | 10,215 | 42.68 | -7.67 | 9321 | 38.94 | +4.75 | 3173 | 13.26 | +8.5 |
| Golem | 1,889 | 45.37 | -9.46 | 1,384 | 33.24 | +4.53 | 571 | 13.71 | +8.9 |
| Helmes | 715 | 44.83 | -5.85 | 538 | 33.73 | +1.59 | 260 | 16.30 | +10.5 |
| Kavajë | 5,173 | 39.92 | -11.43 | 5,313 | 41.00 | +8.53 | 1,869 | 14.42 | +10.0 |
| Luz i Vogël | 1,148 | 45.76 | +3.14 | 1,033 | 41.17 | -4.88 | 229 | 9.13 | +4.3 |
| Synej | 1,290 | 47.58 | +1.18 | 1,053 | 38.84 | -1.04 | 244 | 9.00 | +3.5 |

Por, ndryshe nga zonat e tjera të Qarkut të Tiranës, ku PS ka shënuar një rritje mesatare prej 3.5, njësitë e Bashkisë së Kavajës, ku fushata është drejtuar nga Arben Ahmetajt, kanë prodhuar një rezultat katastrofik krahasuar me rezultatin e zgjedhjeve të 2013. Në drejtimin Arben Ahmetajt si përfaqësues politik,

Bashkia e Kavajës, me rezultatin negativ, rrezikoi për dy ditë me radhë mandatin e 18 të Partisë Socialiste në Tiranë. Konkretisht, sipas të dhënave, në zgjedhjet e 25 qershorit 2017, në Kavajë, PS ka marrë 5 173 vota ose 39.92 %, duke pësuar një rënie me 11.43 % krahasuar me rezultatin e katër viteve më parë. Në Golem,

pjesë e Bashkisë Kavajë, PS ka marrë 1 889 vota ose 45.37 %, duke pësuar një rënie me 9.46 % krahasuar me rezultatin e katër viteve më parë. Në Helmes, gjithashtu pjesë e Bashkisë së Kavajës, Partia Socialiste, në zgjedhjet e 25 Qershorit 2017, ka marrë 715 vota ose 44.83 % të votave. Në këtë njësi, Partia

Socialiste ka pësuar gjithashtu një rënie me 5.85 %, krahasuar gjithnjë me rezultatin e arritur në zgjedhjet e 2013. Në të gjithë Bashkinë Kavajë, PS ka marrë 10 215 vota ose 42.68 %, duke pësuar një rënie me 7.67 %.

RIKTHEHET MITI I PD

Nëse në të gjitha zonat e tjera

të Tiranës, Partia Demokratike ka pësuar një disfatë dramatike, Arben Ahmetajt, sipas rezultateve, ka rikthyer mitin e Partisë Demokratike në Kavajë. Në qytetin e Kavajës, PD ka marrë 5 313 vota, ose 41 %, duke shënuar një rritje me 8.53 %, krahasuar me rezultatin e arritur katër vite më parë. Gjithashtu, Partia Demokratike ka shënuar rritje edhe në dy njësitë e tjera të Bashkisë Kavajë, Golem dhe Helmes, ku Partia Socialiste ka shënuar rënie. Në drejtimin e fushatës nga Arben Ahmetaj, PS i ka lëshuar terren Lëvizjes Socialiste për Integrim në Kavajë. LSI ka shënuar rritje në të katër njësitë që përbëjnë këtë bashki. Në qytetin e Kavajës, LSI është rritur me 10 %, në Golem me 8.9 %, në Helmes me 10.5 %, në Synej me 3.5 % dhe në Luz të Vogël me 4.3 %. Prandaj një rritje të LSI në të katër njësitë, një ringritje të Partisë Demokratike dhe një rënie të Partisë Socialiste. Në të gjithë bashkinë, krahasuar me 2013, LSI ka shënuar një rritje me 8.5 %, ndërsa PD me 4.75 %.

ZGJEDHJET / PROJEKT I RI DO TË ZBATOHET NGA ODIHR

BE dhe ODIHR 1.6 milion euro për zgjedhjet, përfiton Shqipëria

Komisioneri i BE-së për Zgjerimin Johannes Hahn dhe Drejtori i Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) Michael Georg Link lancuan dje projektin për të mbështetur zgjedhjet demokratike në Ballkanin Perëndimor. Ky projekt i ri trevjeçar do të zbatohet nga ODIHR dhe do të mbështesë Shqipërinë, Bosnje Hercegovinën, -ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë në përpjekjet e tyre për të ndjekur rekomandimet e vëzhgimit të zgjedhjeve në fushat që lidhen me menaxhimin e zgjedhjeve.

PROJEKT I RI

Projekti i ri trevjeçar do të zbatohet nga ODIHR dhe do të mbështesë Shqipërinë, Bosnje Hercegovinën, -ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë në përpjekjet e tyre për të ndjekur rekomandimet e vëzhgimit të zgjedhjeve në fushat që lidhen me menaxhimin e zgjedhjeve.

Austriake për Zhvillim, njësi operative e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim). Komisioneri Hahn u shpreh se marrëveshja e nënshkruar demonstron angazhimin tonë të fuqishëm për të ndihmuar Ballkanin Perëndimor në rrugën e tij drejt anëtarësimit. "Marrëveshja e

nënshkruar sot demonstron angazhimin tonë të fuqishëm për të ndihmuar Ballkanin Perëndimor në rrugën e tij drejt anëtarësimit në BE. Me këtë mbështetje për zgjedhjet në Ballkanin Perëndimor, Komisioni mbetet i fokusuar në bazat e para në procesin e zgjerimit dhe në vlerat që e mbështesin atë. Demokracia, besueshmëria dhe stabiliteti i organeve të zgjedhura varen qartë nga proceset zgjedhore të lira dhe të ndershme, për të cilat ODIHR jep një kontribut kyç" tha ai. Drejtori i Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) Michael Georg Link tha se ODIHR do të intensifikojë përpjekjet për të nxitur ndjekjen e rekomandimeve elektorale me qëllim që zgjedhjet të zhvillohen më tej në përputhje me angazhimet e OSBE. "Në kuadër të këtij projekti, zyra jonë do të intensifikojë përp-

jekjet për të nxitur ndjekjen e rekomandimeve elektorale me qëllim që zgjedhjet të zhvillohen më tej në përputhje me angazhimet e OSBE dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike", tha drejtori Link. Të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE janë zotuar të ndjekin vlerësimet dhe rekomandimet elektorale të ODIHR-it, ndërsa BE-ja ka vënë në dukje nevojën për të mbështetur ndjekjen e rekomandimeve të ODIHR-it dhe për të forcuar lidhjen me reformat më të gjera demokratike që kërkohen për Ballkanin Perëndimor për të përmbushur Ambicet e Integritimit Evropian. Në kuadër të projektit, ODIHR do të bashkëpunojë ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe ofruesit e ndihmës zgjedhore, si dhe me operacionet në terren të OSBE-së dhe Delegacionet e BE-së.

OFERTË PUNËSIMI

Kompania mediatike Shqiptarja.com kërkon të punësojë agjent marketingu që plotëson kriteret e mëposhtme:

TË KETË ARSIM TË LARTË

TË KETË PËRVOJË PUNE

TË JETË I GATSHËM
PËR TË PUNUAR NË TERREN

Personat e interesuar të dërgojnë CV e tyre në adresën: marketing@shqiptarja.com



ZGJEDHJET PER BASHKINE

REZULTATET PËR 70/84 KUTI

| | | |
|---------------------------------|---------------|-----------|
| Partia Demokratike | Isa Sakja | 9657 vota |
| Partia Socialiste | Dorjan Murati | 9642 vota |
| Lëvizja Socialiste për Integrim | Maksim Kona | 1808 vota |



Luftë e fortë në Kavajë për kreun e Bashkisë, ku Partia Socialiste rrezikon të humbasë pas shumë kohësh nga Partia Demokratike. Deri në pas mesnate kur ishin numëruar 72 nga 84 kuti gjithsej. Partia Demokratike kryesonte me një rezultat shumë të ngushtë, vetëm 15 vota para. Rezultati i përkohshëm PD- Isa Sakja 9657 vota, PS- Dorjan Murati 9642 vota, LSI- Maksim Kona 1808 vota. Kujtojmë se Bashkia e Kavajës shkoi në zgjedhje të parakohshme pas shkarkimit të Elvis Rroshit nga Këshilli i Ministrave.

TENSION DHE VONESË NË FILLIMIN E NUMËRIMIT

Që në mëngjesin e djeshëm është vënë re një tension i shtuar midis forcave politike në Kavajë para fillimit të numërimit të kutive për kryetarin e bashkisë. Palët janë acaruar pasi është vonuar fillimin e procesit të numërimit, sepse numëruesit e Partisë Socialiste nuk janë

paraqitur. Kandidati i PD-së për Kavajën, Isa Sakja deklaroi dje se komisionerët

e PS-së nuk kanë shkuar për të ushtruar detyrën, ndërkohë që është thirrur në ndihmë

edhe policia. Forca të shumta shkuan pranë KZAZ-së. "Duhet të kishte numërimi

në 8 dhe ora 11 ende nuk ka nisur. Partia Socialiste nuk ka sjellë ende numëruesit,

ndërkohë që ka një prani të madhe të policisë në vendin ku do të bëhet numërimi", tha Isa Sakja.

MINISTRI TEKNIK I BRENDSHËM SHKON NË KAVAJË

Ministri teknik i Brendshëm ka shkuar dje në Kavajë, për të ndjekur nga afër procesin e numërimit të votave për kreun e kësaj bashkie. Ministri Demiraj mbërriti me urgjencë në Kavajë fill pas problemit të ndodhur aty, ku numëruesit e PS bllokuan procesin dhe në vend u vuri prani e shtuar e forcave policore. Ministri është parë të takohet me kreun e policisë dhe efektive të pranishëm. "Qëllimi i ardhjes sime është mbarëvajtja e punës së këtij procesi, sigurimi i mbarëvajtjes së punës, është e fundit, jemi për të siguruar një rezultat që të mos jetë i ndikuar. i bëj thirrje mbështetësve të partive të qëndrojnë larg KZAZ dhe të zbatojë ligjin, të lënë numëruesit të zbatojnë detyrën"- tha ministri.

Në Kavajë PS rrezikon bashkinë, luftë deri në votën e fundit

Dorjan Murati i PS-së dhe Isa Sakja i PD-së janë shumë pranë. Fituesi do përcaktohet në kutinë e fundit

DELEGACIONI BE

Pjesëmarrja e ulët në zgjedhje eurodeputetja: Shkak emigracioni

Për Shqipërinë ka qenë "një ditë demokracie", e cila është zhvilluar në një "klime pozitive në krahasim me të kaluarën", edhe pse pati disa dyshime për parregullsi, të cilat nuk ndryshojnë shumë nga ato të vendeve të tjera të Bashkimit Europian. Kështu ka deklaruar eurodeputetja Elly Schlein, zëvendëskryetaria e delegacionit të PE-së për raportet e stabilizim asociimit mes Bashkimit Europian e Shqipërisë. Në një prononcim për agjencinë italiane të informacionit Ansa, Schlein ka shtuar: "Rastet e dyshimit kanë të bëjnë kryesisht me votën familjare, me votën e shumëfishtë dhe me praninë e konsiderueshme të personave jashtë selive të disa qendrave të votimit". Ndërsa për sa i përket pjesëmarrjes së ulët në votime, ajo tha se kjo ka të bëjë me mungesën në votë të mbi 1.2 milionë emigrantëve shqiptarë rezidentë jashtë kufirit shqiptar e që rezultojnë të regjistruar në listat elektorale. Për sa i përket të ardhmes europiane të Shqipërisë, eurodeputetja



Eurodeputetja Elly Schlein

u shpreh se "BE u impenjua të thjeshtojë procedurat për zgjedhje sa më të lira e demokratike, por tashmë rruga e Tiranës drejt Brukselit varet nga ajo çka do ndodh në ditët e ardhshme". "Shpresa është, tha ajo, që të

krijohet shpejt qeveria e re dhe bashkërisht të punohet për zgjerimin e reformave, në mënyrë të veçantë në atë të drejtësisë për një sistem gjyqësor të paanshëm e që gëzon besimin e qytetarëve", tha Schlein për Ansa-n.



THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME

SHOQËRIA CIVILE KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Komiteti Holandez i Helsinkit, Komiteti Norvegjez i Helsinkit, Komiteti Serb i Helsinkit për të drejtat e njeriut dhe Together For Life (TFL) po zbatojnë projektin "Shoqëria Civile Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm", financuar nga Bashkimi Evropian.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti të BE-së i financuar nga Instrumenti për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut është: "Kundërshtimi dhe parandalimi i përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në zonat e largëta të Shqipërisë".

Grupet e synuara të projektit janë organizatat e shoqërisë civile (OSHC), organizatat e bazuara në komunitet, organizatat e mediave, organizatat e grave dhe të rinjve etj.

Kjo thirrje për Projekt-Propozime, është e vlefshme prej datës 09 Qershor - 31 Korrik 2017, dhe i përket Skemës së Granteve, si një nga komponentët kryesorë të projektit, i cili ka si qëllim financimin e projekteve që mbështesin OShC-të që veprojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen e fëmijëve ose të drejtat e njeriut në përgjithësi, grupet me baza në komunitet, grupet rinore. Ne inkurajojmë aplikantët nga të gjitha organizatat me baza fetare, organizatat etnike etj.

Shuma e përgjithshme e vënë në dispozicion në këtë Thirrje për Projekt-Propozime është 187,764 Euro.

Tre sesioni informimi do të organizohen respektivisht në datë 12/07/2017 ora 12:00 në Gjirokastrë, në datë 13/07/2017 at 12:00 në Tiranë dhe në datë 14/07/2017 ora 12:00 në Shkodër.

Buxheti i përgjithshëm i projektit për çdo grant të kërkuar në këtë Thirrje për Projekt-Propozime duhet të jetë midis shumave minimale dhe maksimale si në vijim:

EUR 5,000.00 - 10,000.00

Afati i fundit i dorëzimit të Projekt-Propozimeve është 31 Korrik 2017 ora 17:00.

Udhëzimet për mënyrën e aplikimit dhe dorëzimit të Projekt-Propozimeve, përshkruhen në Udhëzimin për Aplikim të Granteve, e cila mund të gjendet në (LINKU i manualit) ose në internet, në faqen zyrtare të KSHH www.ahc.org.al dhe atë të TFL www.togetherforlife.org.al

Një kopje e Udhëzimit për Aplikime dhe formatit të aplikimit mund të kërkohet edhe duke dërguar një e-mail në adresën: office@ahc.org.al.

Thirrje për Projekt-Propozime
EuropeAid/152207/DD/ACT/AL
Shoqëria Civile Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
Albanian Helsinki Committee

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



Rekordi i PS në Tiranë fitore e thellë në 24 njësitë

Qytetarët vlerësuan punën e bërë nga Bashkia e Tiranës në këto dy vite

Tirana rezultoi në këto zgjedhje si lokomotiva e fitores së Partisë Socialiste. Projektet madhore si ai i sheshit "Skënderbej", Pazari i Ri, Bulevardi i Ri, Unaza e Vogël, por edhe puna e bërë në çdo lagje, duke filluar nga çerdhet, kopshtet, shkollat, këndet e lojërave, si dhe gjithë infrastruktura urbane, kanë dhënë efektin e tyre në rezultatin e zgjedhjeve. Qytetarët e kryeqytetit vlerësuan me votë punën e bërë nga Bashkia e Tiranës në këto dy vite, duke i dhënë Partisë Socialiste një fitore të thellë, që shkon mbi mesataren e gjithë vendit. Kështu, nëse PS në rang vendi ka siguruar 48% të votave, në Bashkinë e Tiranës rritja mesatare shkon në 51.2%, pra mbi 3 për qind më shumë se sa mesatarja kombëtare. Një element tjetër i rëndësishëm që rezultoi deri më tani, kur kanë mbetur për t'u numëruar shumë pak kuti, është se për herë të parë në historinë e këtyre viteve demokraci, PS ka mundur të fitojë të 24 njësitë administrative që përbëjnë Bashkinë e Tiranës, përfshi këtu edhe zona të tilla që konsiderohen si bastione të PD-së, siç është Lapraka. Në të gjitha njësitë administrative të Tiranës qytet, PS ka siguruar një rezultat që krahasuar me 4 vite më parë rritja shkon deri në 8 për qind, ku rritja më e madhe është shënuar në njësitë 8, 9 dhe 10. Një tjetër e dhënë interesante për Tiranën është edhe vota në zonat rurale. Të gjitha njësitë

PERQINDJA E VOTAVE TE PS SIPAS NJESIVE

| NJESIA | 2017 | RRITJA NGA 2013 |
|-----------------------|--------|--------------------|
| ■ Dajt | 56,00% | + 4 % |
| ■ Farkë | 46,17% | + 13 % |
| ■ Kashar | 53,80% | + 11 % |
| ■ Krrabë | 69,91% | + 36 % |
| ■ Ndroq | 59,45% | + 16 % |
| ■ Petrelë | 62,29% | + 17 % |
| ■ Pezë | 63,41% | + 21 % |
| ■ Shëngjergj | 47,27% | + 6 % |
| ■ Vaqarr | 59,87% | + 2 % |
| ■ Baldushk | 50,62% | + 5 % |
| ■ Bërzhitë | 55,53% | + 10 % |
| ■ Zall-Bastar | 53,46% | + 6 % |
| ■ Njësia Bashkiake 1 | 51,30% | + 5 % |
| ■ Njësia Bashkiake 2 | 50,21% | + 5 % |
| ■ Njësia Bashkiake 3 | 52,00% | + 8 % |
| ■ Njësia Bashkiake 4 | 51,86% | + 6 % |
| ■ Njësia Bashkiake 5 | 53,38% | + 2 % |
| ■ Njësia Bashkiake 6 | 53,75% | + 3 % |
| ■ Njësia Bashkiake 7 | 51,94% | + 3 % |
| ■ Njësia Bashkiake 8 | 43,56% | + 4 % |
| ■ Njësia bashkiake 9 | 50,80% | + 6 % |
| ■ Njësia Bashkiake 10 | 51,46% | + 8 % |
| ■ Njësia Bashkiake 11 | 44,98% | + 2 % |



Investimi

Erion Veliaj u bëri rrugën pas 68 vitesh, PS fiton 70% në Krrabë



Partia Socialiste ka arritur një fitore të thellë në njësinë e Krrabës në këto zgjedhje duke siguruar 70 për qind të votave nga 34 për qind që ka qenë rezultati në zgjedhjet e vitit 2013. Premtimi i mbajtur i kryebashkiakut Erion Veliaj për të rikonstruktuar për herë të parë rrugën pas 68 vitesh është shpërblyer më së miri edhe në rezultatat e arritura në këtë njësi. Brenda një kohe të shkurtër, falë investimit të kryer nga Bashkia e

Tiranës u rikonstruktua rruga Mushqeta-Krrabë, e cila lidh autostradën me Krrabën. Rruga i shërben pjesës më të madhe të banorëve të Njesisë Administrative Krrabë, qoftë në lëvizjen më të mirë dhe të shpejtë të njerëzve, por edhe të produkteve bujqësore dhe blegtorale drejt Tiranës. Puna e bërë në këto dy vite nga Bashkia e Tiranës duket se është një nga faktorët kryesorë që ka ndikuar në fitoren e thellë të Partisë Socialiste në Tiranë.

administrative që më parë i përkisnin ish-komunave, një pjesë e të cilave kanë qenë bastione të PD-së, jo vetëm që kanë nxjerrë fituese PS-në, por kanë dhënë rezultate që i kanë

dhënë socialistëve një fitore të thellë. Rekordin e shënon Njësia e Krrabës ku rritja e PS-së ka qenë me 36%, më pas vijnë me radhë: Peza me 21% rritje, Petrela me 17%, Ndroqi

me 16% rritje, Farka me 13%, e kështu me radhë. Natyrisht që këto shifra janë më së pari rezultat i vëmendjes dhe punës që kanë bërë Bashkia e Tiranës në zonat rurale.

HUMBËSIT / VELIAJ E KISHTE PARALAJMËRUAR SE BOGDANI NUK DO ISHTE NË PARLAMENTIN E RI

Pas thirrjes së Veliajt Tirana refuzoi ata që prishën lodrat



Gert Bogdani nuk do të jetë më deputet i Partisë Demokratike. Ai është një nga dështimet e humbjes së thellë që Partia Demokratike pësoi në Tiranë, duke marrë vetëm 11 mandate. Por, Bogdani mbahet mend edhe si një nga ish-deputetët e PD, së bashku me Gent Strazimirin me pistoletë, që organizuan shkatërrimin e këndit të lojërave për fëmijë të Liqeni Artificial. Asokohe, fotot e Bogdanit duke prishur rrethimin e

kantierit dhe Strazimirin me pistoletë bënë xhiron e rrjetit. Me sa duket qytetarët e Tiranës nuk ia kanë harruar këtë lajthitje dhe e kanë ndëshkuar duke e lënë jashtë Parlamentit. Kryebashkiaku Veliaj e kishte paralajmëruar më herët se Bogdani nuk do të ishte më në Parlamentin e ri dhe u kishte bërë thirrje qytetarëve të Tiranës të mos e votonin. Si duket, qytetarët e kanë dëgjuar thirrjen e Veliajt. "Kandidatët që PD ka sjellë prapë në lagjen tuaj

janë Gert Bogdani dhe Gent Strazimiri. Jam i sigurt që nuk ka njeri normal në PD që t'i thotë Gert Bogdanit dhe atij Strazimirit bravo të qoftë që shkatërrova lodrat e kalamajve dhe unë do të votoj ty prapë që të vazhdosh të shkatërrosh të tjera lodra kalamajsh", deklaronte Veliaj. Siç shihet edhe nga rezultatet, qytetarët e Tiranës i dhanë të drejtë Veliajt duke i dhënë PS-së një numër rekord deputetësh në kryeqytet, plot 18 mandate.

**SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017**



QARKU TIRANE

PS fitore të thellë, PDIU pretendon mandatin e humbur

Doda: Gabim teknik në hedhjen e rezultatit, mandati i yni, Idrizi është zgjedhur deputet

Rekord historik ka arritur Partia Socialiste në Qarkun e Tiranës ku ka marrë 18 mandate deputetësh. Asnjë forcë politike nuk ka mundur të nxjerrë kaq shumë deputetë nga një qark. PS-ja ka pasur si forcën kryesore të fitores së thellë të saj Bashkinë e Tiranës. PS ka mundur të fitojë të 24 njësitë administrative që përbëjnë Bashkinë e Tiranës, përfshi këtu edhe zona të tilla që konsiderohen si bastione të PD-së, siç është Lapraka. Partia Demokratike ka arritur të fitojë vetëm në Kamëz, ku në këtë bashki ka dalë forcë e parë me gati 6 mijë vota më shumë se socialistët që u renditën të dytët. Gjithsesi kjo nuk e ndryshoi shumë situatën, pasi demokratët arritën të marrin vetëm 11 mandate.

PDIU KËRKON MANDATIN

Mandati i 18-të që fitoi PS-ja ka qenë i luftuar gjatë gjithë ditës së djeshme me PDIU. Pas numërimit të kutive të fundit sipas llogarive zyrtare doli që PDIU nuk arriti për pak vota të kalojë pragun e 3% që do t'i jepte mandatin kryetarit të saj Shpëtim Idrizi. Por nga ana e PDIU pretendohet se ka një gabim teknik. "Shpëtim Idrizi është deputet i Tiranës", kështu është shprehur Mesila Doda në një deklaratë për mediat. Doda tha se mandati i PDIU është i sigurt por sipas saj janë gabimet teknike që nuk i dhanë fitoren Idrizit. Doda deklaroi se janë mbi 60 vota të PDIU që nuk janë hedhur në sistem si dhe vota të hedhura gabim në një subjekt tjetër. "Ta fillojmë me këmbë të mbarë, dua t'iu uroj fitoren anëtareve të PDIU sepse arritëm të dyfishonim numrin e votuesve tane në këto zgjedhje që kanë qenë diskriminuese për ne. Mandati i Tiranës është i PDIU, zoti Shpëtim Idrizi i PDIU është deputet i Shqipërisë. Janë mbi 60 vota të njësisë 5 që nuk janë hedhur në sistem dhe kemi ankimet për votat e PDIU të hedhura gabim në një subjekt tjetër. Këto vota janë të mjaftueshme që Idrizi të marrë mandatin. Të gjithë të festojmë, mandati i Tiranës është i sigurtë është i Shpëtim Idrizit", tha Doda.



KAMZA
Partia Demokratike ka arritur të fitojë vetëm në Kamëz, ku në këtë bashki ka dalë forcë e parë me gati 6 mijë vota më shumë se socialistët që u renditën të dytët.



**REZULTATET NE KOHE
REALE TE QARKUT TIRANE**

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas



| PËRDITËSIMI I FUNDIT: 19:58 | | | QENDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 1198 / 1198 | | | |
|-----------------------------|--------|---------|---|-------|----------|------|
| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 56,296 | 13.56 | 7.94 | 5 | 1 |
| | PS | 199,721 | 48.11 | 44.57 | 18 | 6 |
| | PKD | 879 | 0.21 | 0.12 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 2,397 | 0.58 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 1,212 | 0.29 | 2.23 | 0 | 0 |
| | PD | 127,404 | 30.69 | 33.28 | 11 | 3 |
| | PBDKSH | 173 | 0.04 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 117 | 0.03 | 0.08 | 0 | 0 |
| | PSD | 801 | 0.19 | 0.58 | 0 | 0 |
| | AD | 221 | 0.05 | 0.11 | 0 | 0 |
| | FRD | 1,723 | 0.42 | 2.13 | 0 | 0 |
| | PDS | 834 | 0.2 | 0.44 | 0 | 0 |
| | PDIU | 12,329 | 2.97 | 1.89 | 0 | 1 |
| | AAK | 185 | 0.04 | 0.07 | 0 | 0 |
| | MEGA | 67 | 0.02 | 0.05 | 0 | 0 |
| | PKSH | 284 | 0.07 | 0.04 | 0 | 0 |
| | APD | 963 | 0.23 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 9,489 | 2.29 | 0 | 0 | 0 |



Rama: Populli foli troç, PS fuqi e vetme qeverisëse e vendit

Partia Socialiste ka festuar dje në Sheshin "Skënderbej" fitoren e madhe në zgjedhje

Partia Socialiste ka festuar pasditën e djeshme në sheshin "Skënderbej" në Tiranë fitoren e zgjedhjeve të 25 qershorit. Kryeministri Edi Rama falënderoi të gjithë shqiptarët, të majtë dhe të djathtë për besimin që i dhënë për të drejtuar i vetëm qeverinë e re, ndërsa përjashtoi mundësinë e koalicioneve, pasi u shpreh se opozita do të jetë dyngjyreshe, PD-LSI. Rama u shpreh se Shqipëria foli troç, populli ka zgjedhur PS, për ta udhëhequr vendin në këtë mision si fuqi e vetme qeverisëse. "Shqipëria ka folur troç, shqiptarët vendosën me një votë qartësisht kuqezi. Ata kanë zgjedhur të ardhmen dhe na kanë thënë se Shqipëria që duam është mbi të majtën dhe të djathtë. Shteti që duam është i qytetarëve dhe jo i pushtetarëve. Misioni i të zgjedhurve është puna për Shqipërinë, jo politika e kacafytjeve për partinë. Populli ka zgjedhur PS, për ta udhëhequr vendin në këtë mision si fuqi e vetme qeverisëse. "Për të mos harruar se në vend të një koalicioni mes partive që ndajnë tepsinë, shqiptarët zgjedhën koalicionin e drejtpërdrejtë me ta, por për ta çuar atë tepsia për skrap përgjithmonë" tha Rama.

"OPOZITA DYNGJYRESHE, JO ARMIKE"

Kryeministri theksoi se pavarësisht fitores së thellë dhe faktit, që PS e formon e vetme qeverinë, opozita dy ngjyreshe, PD-LSI nuk do të trajtohet si armike. "Për ne nuk mund të ketë nder më të madh, nuk ka investim më të madh, ndaj mos e thënë Zoti që besimin ta marrim si kupë futboll. Prioriteti ynë, reflektimi për sa kemi për të ndryshuar në punën tonë. Mos qoftë e thënë që konkurrentët tanë, ti shohim si armiq të mundur dhe t'i trajtojmë si të tillë, ne nuk kemi fituar një kampionat, por kemi marrë një përgjegjësi të madhe. 4 vitet që vijjnë nuk duhet të jenë një tjetër lojë politike se kush e

ka fajin, por një përpjekje për ta bërë Shqipërinë më të mirë. Ne duhet ta bëjmë më të fortë demokracinë tonë. Duhet të veprojmë me shembullin tonë dhe populli do të shikojë kush është i gatshëm të bëjë të njëjtën gjë, jo vetëm me fjalë, por me vepra. Prandaj dua t'u them, udhëheqësve të partive të opozitës se shqiptarët na kanë duruar dhe zgjedhjen e tyre e kanë bërë, tani ta vendosim Shqipërinë para partisë. Shqiptarët

para dallimeve politike dhe hendqeve tradicionale. E ardhmja nuk vjen po arrihet, sa më shumë të bashkëpunojmë aq më pak e shkuara do të jetë pengesë për Shqipërinë që duam. Ky besim i madh, që na është dhënë nga kaq shumë njerëz edhe përtej kufirit të partive. Opozita dy ngjyreshe në 4 vitet e ardhshme. Nëse do të jemi pak më shumë shqiptarë dhe pak më pak politikanë, asgjë nuk do ta ndalte Shqipërinë të

bëhej zonja e rëndë që ëndërronin rilindësit tanë" shprehet ai.

"FALENDEROJ BASHËN, VENDOSI SHQIPËRINË MBI PARTINË"

Pavarësisht fitores së thellë, Rama tha se marrëveshja me Bashën do të jetë një busull për qëllimin e përbashkët, integrimin e Shqipërisë në BE. "Padyshim që as marrëveshja me PD nuk ishte perfekte, por besoj

se nuk do të fashitet. Qeveria dhe opozita të ndara, por duhet të jenë të bashkuara në rrugën për Europën që duam. Duke pasur një fitues kaq të qartë do të duhet nëse fryma e marrëveshjes që shpëtoi zgjedhjet dhe solli një klimë të pazakonshe nuk është tretur me pritshmërinë e Bashës për të dalë fitues, por dua të rikonfirmoj dëshirën për ta pasur marrëveshjen një busull të marrëdhënies mes qeverisë dhe opozitës. E falënderoj Bashën, pasi në 18 maj vendosi Shqipërinë të parën, dhe sikur e shohim, marrëveshja është ajo që është dhe jo ajo që cinikët e kazanit donin që të ishte".

RAMA THUMBON METËN

Gjatë fjalës së tij, Rama ka thumbuar edhe Metën pas deklaratave në fusthtë javën e fundit. "Zgjedhjet nuk ishin perfekte, por më të çliruara nga pesha e traditës sonë, qytetarët u ndjenë më të patrazuar, apo influenca e partive në qeverisje. Shfaqja e papritur dhe disa çjerrje acaruese përbën një përjashtim që më mirë të mos kishte ndodhur, por nuk i cenon arritjet që solli ky proces".

FALENDERON LINDËN, ANETËN DHE GRAMOZIN

Në fund Rama, pasi shprehu mirënjohjen dhe kërkoi duartrokitjet për skuadrat e të gjitha qarqeve, ai falënderoi edhe bashkëshorten dhe nënën për mbështetjen. "Pa Gramozin PS nuk do ishte këtu, ndërsa pa Linda Ramën unë nuk do të isha këtu ku jam. Prapë po kthehem te gruaja, faleminderit Linda që vazhdon të më durosh shumë më heroikisht sesa duroj unë ata të kazanit të katundit. Faleminderit edhe Aneta Ramës. Besoj që kur të rritet Zaho nuk do të mbajë mend asgjë nga kjo fushatë, jo vetëm se është shumë i vogël, por i depolitizuar në një çati ku nuk shikohen lajme dhe emisione politike dhe nuk flitet për politikë në prani të tij" përfundoi Rama.

MESAZHET/ LIDERËT BOTËRORË URIME KREUT TË PS-SË

Merkel, Gentiloni dhe Erdogan urime Ramës për fitoren

Pas fitores së Partisë Socialiste në zgjedhjet e 25 qershorit, kryeministri Edi Rama i kanë ardhur disa mesazhe urimi nga disa prej liderëve më të rëndësishëm botërorë. Kancelarja e Gjermanisë Angela Merkel, Kryeministri i Italisë Paolo Gentiloni dhe Presidenti i Turqisë, Erdogan.

MERKEL: URIME TË MERITUARA, PRES TË TAKOHEMI!

Urimi i parë për Edi Ramën pas fitores së zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit, vjen nga kancelarja gjermane, Angela Merkel. Përmes një mesazhi drejtuar kreut të qeverisë shqiptare, kancelarja gjermane e uron atë për fitoren e PS. "Urime të merituar. Pres të takohemi për pak ditë", shkruan Merkel duke iu referuar puni-

meve të samitit të BE me vendet e Ballkanit Perëndimor në Trieste, Itali, më 12 korrik. Kryeministri Edi Rama dhe kancelarja Ange-

la Merkel pritët të takohen gjatë punimeve të samitit të BE-së, me vendet e Ballkanit Perëndimor në Trieste, Itali, më 12 korrik.

KRYEMINISTRI ITALIAN URON RAMËN: E MERITUAR

Kryeministri italian Paolo Gentiloni ka uruar Edi Ramën për fitoren e zgjedhjeve të 25 qershorit në Shqipëri. Gentiloni e cilëson rezultatit e zgjedhjeve si fitore të merituar për Shqipërinë dhe shembull. "Një fitore e merituar për Shqipërinë. PS një shembull i veçantë. Urime gjithë shqiptarëve".

ERDOGAN: FITORJA FORCON MARRËDHËNIET

Pas Merkelit dhe kryeministrit italian, kryeministritin Edi Rama për fitoren e zgjedhjeve e ka uruar edhe Presidenti i Turqisë, Erdogan. Presidenti turk thotë se fitorja i forcon akoma më shumë marrëdhëniet mes dy vendeve, pasi Shqipëria dhe Turqia janë partnerë strategjikë. Në mesazhin e tij, Presi-



denti Erdogan nuk harron që të urojë edhe Bajramin për shqiptarët, që janë në shumicë myslimane. "Përgëzime për fitoren spektakolare. Kjo fitore



forcon marrëdhëniet tona. Shqipëria dhe Turqia partnerë strategjikë. Gëzuar Bajramin gjithë shqiptarëve" thuhet në mesazhin e tij drejtuar Ramës.

SHËRBIMI PËRMBARIMOR "ASTREA"

NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 1 PËR:

Are me sipërfaqe 500 m2. Vendndodhja: Laknas, Tiranë Regjistruar pranë Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Zona Kadastrale: 2372 Volumi 9, Faqe 234, Nr.Pasurise 151/138.

Çmimi me të cilin fillon ankandi është **1,600,000 (një milion e gjashtëqind mijë) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **12.07.2017, Ora 16:00**, pranë Shërbimit Përmbarimor "ASTREA" shpk, Rr."Kajo Karafil", Pll.pas Lidhjes se Shkrimtareve, Hyrja 1, Kati 2, Zyra nr.1004, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni cel.0696334695 email: sherbimipermbarimorastrea@gmail.com

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU SHKODER

Shkodra mbetet ende bastion i PD-së, Ndoka fiton mandatin

Demokratët ruajnë kryesimin me 5 mandate, PS 4, LSI 1, fiton një mandat Tom Doshi me PSD

Qarku i Shkodrës mbetet ende një bastion i Partisë Demokratike. Vetëm këtu dhe në Kukës demokratët kanë dalë forcë e parë politike. Gjithsesi mandati i pestë i PD-së ka qenë i luftuar deri në momentet e fundit me Partinë Socialiste pasi të dyja partitë e mëdha kanë qenë shumë pranë. Deri në orët e vona të mëngjesit të ditës së djeshme ky mandat ndryshonte sa nga një krahë në tjetrin, derisa paradite kutitë e fundit që i përkisnin qytetit të Shkodrës e ndryshuan situatën në favor të PD-së. Kështu me rreth 1500 vota më shumë demokratët dolën forcë e parë dhe mandate i pestë i shkoi aleatit Nard Ndoka që është future në listën e PD-së pas marrëveshjes me Bashën.

PSD-JA DEL FORCË E TRETË

Tom Doshi ka konfirmuar edhe një herë peshën personale që ka në Qarkun e Shkodrës duke marrë jo vetëm mandatin e deputetit nën siglën e Partisë Social Demokratike, por duke u renditur forcë e tretë në këtë qark, duke kaluar edhe LSI-në. PSD-ja mori 13094 vota 11.97%, ndërsa LSI-ja mori 12777 vota, 11.68%

TOM DOSHI: RAMA TË MBAJË PREMTIMET QË I KA DHËNË SHKODRËS

Tom Doshi ka reaguar pas marrjes së mandatit në Shkodër. Nëpërmjet një konference për shtyp, ai tha se Kryeministri Rama e ka uruar për fitoren dhe se premtimet e tij kanë mbështetjen e Ramës për mandatin katër vjeçar. Për ministrin Ditmir Bushati tha se "ai ka lindur i zi dhe s'ka pse ta komentojë". Deputeti Tom Doshi, premtoi se do të mbështeste Vllazninë në sezonin e ardhshëm, që të formojë një skuadër të mirë ndryshe nga 5 vitet e fundit. "Unë e mora i vetëm mandatin dhe me shumë faktorë kundër meje duke tentuar të më dëmtojnë. Çfarë nuk është bërë, janë blerë 3 vota 1mln lekë të vjetra apo 100 euro. Bëra gabim që bëra atë miting sepse i furi frikën kundërshtarëve dhe morën masa. Prisja një rezultat edhe më të mirë", tha Doshi. Tom Doshi u shpreh i kënaqur për ndarjen e Edi Ramës me Ilir Metën, të cilin e quajti "kancer" për qeverinë. "Fat i madh që PS arriti të fitojë qeverisjen vetëm. Unë i kam thënë Edi Ramës që nuk ka qenë kryeministër, me atë kancer që ka pas, me Ilir Metën dhe me gjithë ato parti që i kërkoni drejtori. Unë nuk i kërkoj asgjë Edi Ramës vetëm të bëjmë këto premtime që i kam dhënë Shkodrës"




NË FOTO:
Tom Doshi



REZULTATET NE KOHE REALE
TE QARKUT SHKODER

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas



FITUESIT

Partia Demokratike: Romeo Gurakuqi, Izmira Ulqinaku, Lorenc Luka, Bardh Spahia e Nard Ndoka. Partia Socialiste: Ditmir Bushati, Paulin Sterkaj, Senida Mesi e Luan Harusha. LSI-ja Agron Çela dhe PSD-ja Tom Doshi

| PËRDITËSIMI I FUNDIT: 11:20 | | | QENDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 419 / 421 | | | |
|-----------------------------|--------|--------|---------------------------------------|-------|----------|------|
| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 12,777 | 11.68 | 10.61 | 1 | 1 |
| | PS | 38,975 | 35.64 | 32.12 | 4 | 6 |
| | PKD | 190 | 0.17 | 4.73 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 67 | 0.06 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 239 | 0.22 | 4.27 | 0 | 0 |
| | PD | 40,506 | 37.04 | 37.23 | 5 | 3 |
| | PBDKSH | 76 | 0.07 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 148 | 0.14 | 0.05 | 0 | 0 |
| | PSD | 13,094 | 11.97 | 0.42 | 1 | 0 |
| | AD | 29 | 0.03 | 0.1 | 0 | 0 |
| | FRD | 78 | 0.07 | 2.06 | 0 | 0 |
| | PDS | 56 | 0.05 | 1.94 | 0 | 0 |
| | PDIU | 2,167 | 1.98 | 0.19 | 0 | 1 |
| | AAK | 6 | 0.01 | 0.06 | 0 | 0 |
| | MEGA | 3 | 0 | 0.03 | 0 | 0 |
| | PKSH | 18 | 0.02 | 0.03 | 0 | 0 |
| | APD | 29 | 0.03 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 910 | 0.83 | 0 | 0 | 0 |

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU
KUKËS

Qarku mbeti bastion i djathtë, por PS +19%, e para në Bashkinë Kukës

Në rast se Kodheli do të jetë sërish ministre, Safet Gjici ndoshta deputet

Pasi i dhanë Partisë Socialiste gati 7 mijë vota më shumë se sa më 2013 dhe demokratëve rreth 2.500 vota më pak, votuesit e Kukësit, qarkut më të vogël në Shqipëri për nga numri i deputetëve, vendosën të dërgojnë dy deputetë nga PD dhe një nga PS në Kuvendin e Shqipërisë. Ish-ministri demokrat Flamur Noka dhe ish-sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme Isuf Çelaj do të jenë përfaqësuesit e Qarkut të Kukësit për Partinë Demokratike. Nga ana e socialistëve, mori mandatin e mbetur ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli. Por, ka një shans edhe i dyti në listën e kandidatëve të PS, Safet Gjici, në rast se Partia Socialiste do ta vijojë praktikën e dorëheqjes së ministrave nga posti i deputetit dhe në rast se Kodheli do të vijojë të jetë ministër.

Në qarkun e Kukësit të dielën kishin të drejtën e votës 81 mijë shtetas, 5 mijë më shumë se sa në zgjedhjet e vitit 2013, ndërsa në kutitë e votimit u hodhën më pak se 43 mijë vota, 5 mijë më pak se sa më 2013, pra rreth 8-10 mijë vetë vendosën të shprehen me mospjesëmarrje në zgjedhje. Nga votat e hedhura, 853 qenë vota të pavlefshme, shifra më e lartë e votave të pavlefshme e regjistruar në krahasim me dy zgjedhjet e kaluara.

Partia Demokratike pati siguruar gati 58 për qind të votave të Qarkut në zgjedhjet e vitit 2009, kur Kukësi shijoi për herë të parë lidhjen rrugore të shpejtë me Tiranën. Por entuziazmi ndaj PD-së në Kukës duket se u zvenit me kalimin e viteve. Në zgjedhjet e vitit 2013, PD arriti të fitojë Kukësin me 50 për qind të votave ndërsa të dielën fitoi vetëm 47 për qind. Në total, votat e munguara në Kukës anojnë nga Partia Demokratike, pasi PS e përmirësoi dukshëm rezultatin e saj. PS pati marrë 19 për qind më shumë

PJESËMARRJA

Në qarkun e Kukësit të dielën kishin të drejtën e votës 81 mijë shtetas, 5 mijë më shumë se sa në zgjedhjet e vitit 2013, ndërsa në kutitë e votimit u hodhën më pak se 43 mijë vota, 5 mijë më pak



Safet Gjici

ZONAT

Surpriza më e madhe ka ndodhur për qytetin e Kukësit, ku për herë të parë që nga 1992, forcë e parë ka dalë PS-ja. Megjithatë, ishte Hasi dhe Tropoja, të cilët përmbysën rezultatin e papritur në qytet Kukës

vota nga 2013-a. Por, surpriza më e madhe ka ndodhur për qytetin e Kukësit, ku për herë të parë që nga 1992, forcë e parë ka dalë PS-ja. Megjithatë, ishte Hasi dhe Tropoja, të cilët përmbysën qytetin e Kukësit, duke i dhënë 2 deputetë. Kurse Lëvizja Socialiste për Integrim mori 2900 vota në Kukës, gjysma e atyre që kishte marrë më 2013 kur pati garuar në koalicionin e majtë.



REZULTATET NE KOHE REALE
TE QARKUT KUKËS

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas



PËRDITËSIMI I FUNDIT 23:52

QËNDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 173/173

| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
|------|--------|--------|-------|-------|----------|------|
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 2,936 | 6.99 | 12.21 | 0 | 1 |
| | PS | 18,331 | 43.63 | 24.64 | 1 | 6 |
| | PKD | 73 | 0.17 | 0.06 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 8 | 0.02 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 272 | 0.65 | 4.81 | 0 | 0 |
| | PD | 19,812 | 47.16 | 47.4 | 2 | 3 |
| | PBDKSH | 14 | 0.03 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 26 | 0.06 | 0.01 | 0 | 0 |
| | PSD | 77 | 0.18 | 1.03 | 0 | 0 |
| | AD | 8 | 0.02 | 0.15 | 0 | 0 |
| | FRD | 51 | 0.12 | 0.67 | 0 | 0 |
| | PDS | 29 | 0.07 | 0.33 | 0 | 0 |
| | PDIU | 14 | 0.03 | 1.07 | 0 | 1 |
| | AAK | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | MEGA | 3 | 0.01 | 0.04 | 0 | 0 |
| | PKSH | 20 | 0.05 | 0.02 | 0 | 0 |
| | APD | 17 | 0.04 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 319 | 0.76 | 0 | 0 | 0 |

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU
LEZHË

Lezha, ndahet në barazim, PS 3 mijë vota para PD-së

LSI merr mandatin e Viktor Tushes, LIBRA e Ben Blushit siguron vetëm 778 vota

ELTON QYNO
TIRANE

Qarku i Lezhës është mbyllur me një "Barazim të paqtë". Ky ka qënë rezultati i numërimit të votave në qarkun e Lezhës. Aty ku situata parashikohet të ishte e shoqëruar me trazira, gjatë procesit të numërimit të votave nuk është rregjistruar asnjë incident. PD dhe PS kë në ndarë një barazim të paqtë, ndërkohë 1 mandat deputeti e ka marrë LSI. Në Lezhë PS ka marrë mandatin e deputetit, Lindita Nikolla, Pjerin Ndreu dhe Gjetan Gjetani. Ndërsa PD ka marrë mandatin Aldo Bumçi, Lindita Metaliaj, Andon Frrokaj. E pamundur për të marrë mandatin e deputetit ka qënë për Preç Zogaj, që ndodhej i katërti në listën e PD. Gjithashtu LSI ka arritur të marrë një mandat, deputeti Viktor Tusha. Në përfundimin e 263 kuti votimi, PS ka marrë në total 30360 vota, PD 27655 vota dhe LSI 11232 vota. Ndërsa LIBRA, partia e Ben Blushit ka marrë vetëm 778 vota. Ndryshe nga procesi i votimit ku pati përplasje me armë dhe disa arrestime për blerje votash, procesi i numërimit të votave në kuti ka qënë i qetë.



Viktor Tushaj

NUMËRIMI

Ndryshe nga procesi i votimit ku pati përplasje me armë dhe disa arrestime për blerje votash, procesi i numërimit të votave në kuti ka qënë i qetë.

3 MIJË VOTA

Në përfundimin e 263 kuti votimi, PS ka marrë në total 30360 vota, PD 27655 vota dhe LSI 11232 vota. Ndërsa LIBRA, partia e Ben Blushit ka marrë vetëm 778 vota.

të këtij incidenti, pasi sipas tij, ka nxitur bandat kriminale në Lezhë. Meta tha se do qëndrojë bashkë me eksortën e tij në Lezhë, deri në numërimin e votës së fundit. "Do ta mbroj popullin e Lezhës nga bandat e Rilindje. Kam ardhur këtu bashkë me eskortën time dhe do të qëndroj këtu deri në numërimin e votës së fundit të lezhjanëve. Sadisti i Shqipërisë kërkon ta kthejë Lezhën në mini-Siçili siç e shndërroi në këto katër vite".



REZULTATET NE KOHE REALE
TE QARKUT LEZHË

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas




PËRDITËSIMI I FUNDIT 17:18

QËNDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 263/263

| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
|------|--------|--------|-------|-------|----------|------|
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 11,232 | 15.33 | 11.23 | 1 | 1 |
| | PS | 30,360 | 41.45 | 34.45 | 3 | 6 |
| | PKD | 185 | 0.25 | 0.2 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 73 | 0.1 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 240 | 0.33 | 1.54 | 0 | 0 |
| | PD | 27,655 | 37.76 | 38.06 | 3 | 3 |
| | PBDKSH | 283 | 0.39 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 27 | 0.04 | 0.24 | 0 | 0 |
| | PSD | 31 | 0.04 | 1.25 | 0 | 0 |
| | AD | 13 | 0.02 | 0.07 | 0 | 0 |
| | FRD | 39 | 0.05 | 1.13 | 0 | 0 |
| | PDS | 47 | 0.06 | 0.75 | 0 | 0 |
| | PDIU | 2,111 | 2.88 | 0.68 | 0 | 1 |
| | AAK | 26 | 0.04 | 0.37 | 0 | 0 |
| | MEGA | 8 | 0.01 | 0.04 | 0 | 0 |
| | PKSH | 74 | 0.1 | 0.07 | 0 | 0 |
| | APD | 63 | 0.09 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 778 | 1.06 | 0 | 0 | 0 |

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU
DIBËR

PD-ja humbet kryesimin dhe 1 mandat, PS rrit forcën por jo deputetët

Lala tërhiqet nga deklarat për PS: Mbetem te PDIU, por do bashkëpunoj me Ramën se ka timonin

Edhe pse doli forca e parë politike në Qarkun e Dibrës me 34.4%, Partia Socialiste nuk arriti që të përkthejë këtë në rritje mandatesh. Socialistët që në këtë qark drejtoheshin nga ish-ministri Ilir Beqaj kanë marrë sërish 2 mandate deputeti, aq sa kishin edhe në legjislaturën e kaluar. PD-ja është humbësja e madhe në këtë qark. Demokratët nga 3 mandate kanë fituar vetëm 2, duke marrë 29.4% të votive, gati 10% më pak se zgjedhjet e 2013. LSI-ja arriti që të ruante pak a shumë forcën e saj në Dibër. 17.14% të votive i kanë mjaftuar LSI-së për të fituar një mandate deputeti.



REZULTATET NE KOHE REALE
TE QARKUT DIBËR

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas




VOTAT

Në këtë qark PS e cila ka marrë gjithsej 24715 vota, ndërsa e dyta PD me 21142 vota, e treta doli PDIU-ja me 12531 dhe LSI-ja grumbulloi 12336 vota.

SURPRIZA PDIU

PDIU ka realizuar surprizën e premtuar në Qarkun e Dibrës. Reme Lala ka fituar mandatin e deputetit në siglën e Partisë së Çamëve në qarkun verilindor. Suksesin PDIU-së ia dha Bashkia e Dibrës dhe sidomos qyteti i Peshkopisë. Në Bashkinë Dibër PDIU-ja doli forcë e parë me 9911 vota e dyta PS-ja me 9362 vota, ndërsa PD-ja e treta me 8111 vota.



Reme Lala

PA PROBLEME

Në këtë qark si votimi ashtu edhe numërimi i votës janë kryer në normalitet të plotë. Madje qarku i Dibrës ka qenë një nga të parët që e përfundoi procesin e numërimit.

REME LALA

Deputetja e PDIU-së në qarkun e Dibrës, Reme Lala ka reaguar në Facebook duke sqaruar deklaratën që bëri se i bashkohet PS-së. Lala thotë se deklarata e saj është keqkuptuar, pasi nuk do të bashkohet me PS, por do të bashkëpunojë me Ramën për të bërë rrugën e 'Arbrit'. "Ne te gjithë fushaten tonë, kam thënë që unë nuk kam parti, partia ime jeni ju, Dibra dhe dibranët. Për respektin e dibranëve, për të sqaruar

dhe disa dibranë që mund të jenë keqkuptuar. Dua të bëj realitet fillimin e Rrugës së Arbërit brenda këtij viti. Po Rruga e Arbërit me Edi Ramen bëhet, se Edi Rama e ka timonin! Unë si dibrane, jam e gatshme të bashkëpunoj me këdo që realizon premtimin e Rrugës së Arbërit", shprehet Lala. Deputetja e PDIU-së deklaroi përdje se: "Unë nuk kam asnjë parti, partia ime jeni ju. Për Dibrën do i bashkohem vullnetit të shqiptarëve për t'i dhënë timonin Ramës".

PËRDITËSIMI I FUNDIT 17:19

QËNDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 259 / 259

| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
|------|--------|--------|-------|-------|----------|------|
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 12,336 | 17.14 | 13.19 | 1 | 1 |
| | PS | 24,715 | 34.35 | 34.52 | 2 | 6 |
| | PKD | 197 | 0.27 | 0.02 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 21 | 0.03 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 154 | 0.21 | 2.93 | 0 | 0 |
| | PD | 21,142 | 29.38 | 39.81 | 2 | 3 |
| | PBDKSH | 116 | 0.16 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 35 | 0.05 | 0.04 | 0 | 0 |
| | PSD | 27 | 0.04 | 0.16 | 0 | 0 |
| | AD | 114 | 0.16 | 0.12 | 0 | 0 |
| | FRD | 117 | 0.16 | 3.23 | 0 | 0 |
| | PDS | 159 | 0.22 | 0.34 | 0 | 0 |
| | PDIU | 12,531 | 17.41 | 0.33 | 1 | 1 |
| | AAK | 12 | 0.02 | 0.03 | 0 | 0 |
| | MEGA | 5 | 0.01 | 0.06 | 0 | 0 |
| | PKSH | 32 | 0.04 | 0.03 | 0 | 0 |
| | APD | 20 | 0.03 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 223 | 0.31 | 0 | 0 | 0 |

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU ELBASAN

Elbasan, PD në 4 qytete doli e treta pësoi ulje me 6%

E habitshme, në Peqin, forcë e parë është PDIU me 5859 vota. Ndërsa PD forcë e tretë



ELTON QYNO
TIRANE

Partia Demokratike ka pësuar një humbje të thellë dhe në qarkun e Elbasanit, ku ndryshe nga zgjedhjet e kaluara ku fitorja mes PS dhe PD ndahej shumë ngushtë, kjo forcë politike në këtë qark ka pësuar humbje drastike të votave. Madje në disa qytete të këtij qarku, PD e drejtuar nga Lulzim Basha, ka dalë forcë e tretë. Qarku i Elbasanit në 2009 ka dalë barazim me mandate (6 me 6), gjatë kohës kur Berisha, caktoi si koordinator të fushatës zgjedhore Lulzim Bashën. Në Elbasan janë numëruar 547 kuti, ku PS ka marrë në total 72469 vota e cila ka një rritje 1 për qind me votat e 2013, PD 33569 vota dhe ka një ulje 6 për qind dhe LSI 23457 vota. Rezultatit për sa i përket mandateve ka qënë i tillë, ku PS ka marrë 7 deputetë si Taulant Balla, Evis Kushi, Arben Kamami, Musa Ulqini, Anastas Angjeli, Luan Duzha, Nuri Belba. Ndërsa PD ka marrë 3 deputetë, Edmond Spaho, Endri Hasa, Luçiano Boçi. Tek LSI është zgjedhur deputete Monika Kryemadhi,



REZULTATET NE KOHE REALE
TE QARKUT ELBASAN

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

DEKLARATAT

Ky qark në zgjedhjet e 2013 është dominuar nga fitorja e PS. Procesi i votimit ka shkuar me disa incidente të vogla dhe deklarata të ndërsjellta mes partive politike. PS e Elbasanit akuzoi LSI dhe Monika Kryemadhin se nën shoqërinë e personave me precedent penalë po provokojnë e pengojnë votuesit.



NË PEQIN

E habitshme është fakti se në Peqin, forcë e parë është PDIU, me 5859 vota në total ndërsa PD forcë e tretë. Ndërsa në Prrrenjas dhe Gramsh PD ka dalë forcë e tretë, pasi PS renditet e para dhe e dyta LSI. Edhe në Cërrik PD ka dalë PD forcë e tretë. Procesi zgjedhor në qarkun e Elbasanit përgjithësisht ka shkuar i qetë, përjashtuar disa incidente të vogla, që i kanë prishur rehatinë subjekteve politike por edhe banorëve të zonës ku kanë ndodhur këto incidente. Si një qark, ku përfshin disa qytete si Prrrenjas, Librazhd, Elbasan, Peqin, Cërrik, Gramsh dhe

Belsh, numri personave për të votuar ka qënë 336.969. Sipas të dhënave të KQZ, numri i pjesëmarrësve në zgjedhje ka qënë 45 për qind, në të gjithë qarkun. Ndërkohë 10 mijë e 500 kanë qënë votuese femra në këtë qark.

PËRDITËSIMI I FUNDIT 17:13

QËNDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 547/547

| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
|------|--------|--------|-------|-------|----------|------|
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 23,457 | 14.33 | 10.78 | 2 | 1 |
| | PS | 72,469 | 44.27 | 42.91 | 7 | 6 |
| | PKD | 206 | 0.13 | 0.03 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 200 | 0.12 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 443 | 0.27 | 3.17 | 0 | 0 |
| | PD | 33,569 | 20.51 | 27.04 | 3 | 3 |
| | PBDKSH | 75 | 0.05 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 38 | 0.02 | 0.02 | 0 | 0 |
| | PSD | 92 | 0.06 | 0.28 | 0 | 0 |
| | AD | 82 | 0.05 | 0.08 | 0 | 0 |
| | FRD | 1,037 | 0.63 | 1.28 | 0 | 0 |
| | PDS | 300 | 0.18 | 0.38 | 0 | 0 |
| | PDIU | 29,201 | 17.84 | 7.44 | 2 | 1 |
| | AAK | 49 | 0.03 | 0.04 | 0 | 0 |
| | MEGA | 35 | 0.02 | 0.05 | 0 | 0 |
| | PKSH | 152 | 0.09 | 0.07 | 0 | 0 |
| | APD | 119 | 0.07 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 2,156 | 1.32 | 0 | 0 | 0 |

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU
KORÇË

LIBRA e Blushit zhgënjen në Korçë vetëm 1772 vota

Në Dardhë, aty ku Blushi ka shtëpinë e pushimit LIBRA 6 vota. Ja si ndahen mandatet PD-PS-LSI

ELTON QYNO
TIRANE

Partia Socialiste ka korrur një fitore të merituar në qarkun e Korçës. PS, ka kryesor me vota që në hapjen e kutive të para, ndërkohë, ajo që u vu re ishte një ulje e ndjeshme votuesve të PD, në zonën e Pogradecit, Maliqit, Ersekës dhe qytetit të Korçës. Partia LIBRA e Ben Blushit, që pritet të merrte shumë vota në këtë qark, për shkak dhe të vendlindjes së Blushit, ka arritur të marrë vetëm 1772 vota. Mësohet se LIBRA ka marrë vetëm 6 vota në fshatin Dardhë, aty ku Blushi ka shtëpinë e tij të pushimit. Partia Demokratike ka arritur të marrë vetëm katër deputetë në këtë qark, i gjithë procesi i numërit të kutive në KZAZ-të e këtij qarku, ka qënë i qetë. Nga 463 kuti votimi, deri në orën 21:15 janë numëruar 463 kuti votimi, ku PS ka arritur të numërojë 63521 vota, PD 42763 vota dhe LSI 18931. Partia Socialiste ka marrë 6 deputetë, ku kanë fituar mandatin Niko Peleshi, Eduart Shalsi, Elisa Spiropali, Ilirian Pendavinji, Ilir Xhakolli, Edlira Bode.



Ben Blushi

DEPUTETËT E PS

Partia Socialiste ka marrë 6 deputetë, ku kanë fituar mandatin Niko Peleshi, Eduart Shalsi, Elisa Spiropali, Ilirian Pendavinji, Ilir Xhakolli, Edlira Bode.

DEPUTETËT E PD

PD ka marrë 4 deputetë. Mandatin e kanë fituar profesoria e Historisë Valentina Duka, Ervin Saliq, inxhinjeri Hekuran Hoxhalli dhe Klevis Balliu.

PS ka arritur të marrë një fitore bindëse, ndërkohë PD ka dalë forcë e tretë në këtë qytet, ku ka arritur të numërojë vetëm 1417 vota. Zgjedhjet parlamentare në këtë qarkun e Korçës, kanë nisur duke regjistruar një ngjarje të rëndë, pasi një efektiv i policisë së këtij qarku, ka vrarë vetën me armën e shërbimit. Po ashtu procesi i votimit gjatë 25 qershorit është shoqëruar më arrestimin e tre personave eksponentë të LSI, të akuzuar për blerje të votave. Përgjithësisht procesi i votimit në këtë qark. Ndërkohë humbësit dhe fituesit kanë uruar njëri-tjetrin.



REZULTATET NE KOHE REALE
TE QARKUT KORÇË

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas



| PËRDITËSIMI I FUNDIT 18:12 | | | QËNDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 463/463 | | | |
|----------------------------|--------|--------|-------------------------------------|-------|----------|------|
| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 19,440 | 14.99 | 9.96 | 1 | 1 |
| | PS | 62,699 | 48.35 | 43.54 | 6 | 6 |
| | PKD | 341 | 0.26 | 0.09 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 127 | 0.1 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 399 | 0.31 | 3.04 | 0 | 0 |
| | PD | 41,770 | 32.21 | 31.92 | 4 | 3 |
| | PBDKSH | 279 | 0.22 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 34 | 0.03 | 0.03 | 0 | 0 |
| | PSD | 60 | 0.05 | 0.25 | 0 | 0 |
| | AD | 26 | 0.02 | 0.06 | 0 | 0 |
| | FRD | 195 | 0.15 | 0.99 | 0 | 0 |
| | PDS | 248 | 0.19 | 1.61 | 0 | 0 |
| | PDIU | 2,006 | 1.55 | 0.91 | 0 | 1 |
| | AAK | 7 | 0.01 | 0.08 | 0 | 0 |
| | MEGA | 84 | 0.06 | 0.12 | 0 | 0 |
| | PKSH | 122 | 0.09 | 0.05 | 0 | 0 |
| | APD | 80 | 0.06 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 1,772 | 1.37 | 0 | 0 | 0 |

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU FIER

10 kandidatë në Kuvend nga PS, rritje 12.6 për qind e votave

Nuk zgjidhet asnjë përfaqësues nga komuniteti çam i Fierit këtë herë

Fieri ka shënuar një fitore spektakolare, siç e cilësoi dje, në mitingun e fitores, të organizuar në Tiranë, kryeministri në detyrë Edi Rama. Ai ka falenderuar në mënyrë të veçantë sekretarin e përgjithshëm të kësaj partie, Gramoz Ruçi, i cili u impenjua më shumë se zakonisht, pasi kishte pranuar të ishte vetëm i nënti në listën e kandidatëve dhe megjithatë arriti të futë në Kuvend plot 10 kandidatë nga PS në këtë Qark. Në zgjedhjet e vitit 2013 në Qarkun Fier, Partia Socialiste me aleatët e vet arritën të marrin 62.3 për qind të votave, duke e lënë të djathtë me vetëm 32 për qind. Ndërkohë, vetë Partia Socialiste mori 44%, gati sa dyfishi i Partisë Demokratike. Por këtë vit, pa asnjë aleat në koalicion, PS i rriti masivisht, me 12.6 për qind, votat e saj. Për Partinë Socialiste u siguruan 104,350 vota. Lëvizja Socialiste për Integrim, e cila kishte marrë rreth 20 mijë vota në Fier më 2013, dy herë më shumë se sa më 2009, në këto zgjedhje mori edhe më shumë:



Gramoz Ruçi

21.598 vota, megjithatë nuk arriti më shumë se dy mandate, përfshirë atë të kryetarit aktual të partisë Petrit Vasili. Por nuk mjaftuan të sillnin në Kuvend zëvendësministren e Integritimit, Erisa Xhixho.

Prognozat për një fitore jo të vogël të PS shkaktoi edhe tensioned he incidente gjatë fushatës. Më 14 qershor, LSI nxori kryetarin e saj të ri Petrit Vasili për të denoncuar dhunimin e një aktivisti të saj në zonën e Zharrëzës, në Fier. Gramoz Ruçi iu përgjigj duke argumentuar se nuk dihej nëse dhuna kishte prapaskenë elektorale apo jo. Nga ana e saj PD pati edhe ajo një rritje në masën 2.7% të votave, por këto nuk i sollën më shumë se 4 mandate. Partia Demokratike dhe aleatët e saj morën pesë mandate në Fier më 2013, një më pak se sa në vitin 2009, kur mandati i gjashtë u siguroi pas një përleshjeje fizike dhe ligjore



**REZULTATET NE KOHE REALE
TE QARKUT FIER**

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas



RUÇI

Kryeministri Edi Rama ka falenderuar dje në mënyrë të veçantë sekretarin e përgjithshëm të PS Gramoz Ruçi, i cili ia doli të zgjidhej pasi kishte pranuar të ishte vetëm i nënti në listë

ÇAMËT

Komuniteti çam ka mbetur pa përfaqësues parlamentar në Fier, duke e humbur deputetin që kishte nxjerrë 4 vjet më parë. 6.293 votat s'kanë mjaftuar për të siguruar një vend në Kuvend për përfaqësues të PDIU-së

në ish-komunën Rruzhdiqe, një episod elektorale në të cilin komisionerët e një qendre votimi u gjetën duke mbushur kutitë me vota të votuesve në emigrim. Komuniteti çam ka mbetur pa përfaqësues parlamentar këtë herë në Fier, duke e humbur deputetin që kishte nxjerrë katër vjet më parë. 6.293 votat nuk kanë mjaftuar për të siguruar një vend në Kuvend për përfaqësues të PDIU-së.

PËRDITËSIMI I FUNDIT 17:18

QËNDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 592/592

| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
|------|--------|---------|-------|-------|----------|------|
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 21,598 | 11.81 | 9.84 | 2 | 1 |
| | PS | 104,350 | 57.05 | 44.48 | 10 | 6 |
| | PKD | 155 | 0.08 | 0.09 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 142 | 0.08 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 382 | 0.21 | 1.83 | 0 | 0 |
| | PD | 46,929 | 25.66 | 22.97 | 4 | 3 |
| | PBDKSH | 108 | 0.06 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 81 | 0.04 | 0.01 | 0 | 0 |
| | PSD | 150 | 0.08 | 1.5 | 0 | 0 |
| | AD | 33 | 0.02 | 0.03 | 0 | 0 |
| | FRD | 345 | 0.19 | 1.48 | 0 | 0 |
| | PDS | 548 | 0.3 | 0.44 | 0 | 0 |
| | PDIU | 6,293 | 3.44 | 4.74 | 0 | 1 |
| | AAK | 13 | 0.01 | 0.4 | 0 | 0 |
| | MEGA | 22 | 0.01 | 0.04 | 0 | 0 |
| | PKSH | 119 | 0.07 | 0.06 | 0 | 0 |
| | APD | 50 | 0.03 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 1,599 | 0.87 | 0 | 0 | 0 |


SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU BERAT

Humbja e dhimbshme në Skrapar vetëm 419 vota për PD-në

E paprecedentë në Berat, PD merr vetëm Eduart Halimin. Biznesmeni Astrit Veliaj nuk fiton



ELTON QYNO
TIRANE

Humbja më e thellë e PD, në rang kombëtar ka qënë ajo e Beratit ku kjo forcë politike ka dalë e treta. PD, ka pësuar humbjen më të paprecedentë në historinë e saj në këtë qark, ndërkohë që ka arritur të marrë vetëm një mandat, duke nxjerrë Eduard Halimin si deputet. Nga 305 kuti totale, PS ka arritur të ruajë fitoren e thellë në këtë qark, duke marrë 4 deputetë. PS ka arritur të marrë katër deputetë, ku ka marrë mandatin e Blendi Klosit, Ermonela Felaj, Adnor Shameti dhe Fadil Nasufi. Ndërsa LSI ka marrë dy mandate atë të Nasip Naços dhe Gledion Rahovicës.



Astrit Veliaj

Të vetmin mandat që ka marrë PD është ai i Eduard Halimit. Astrit Veliaj kandidati i PD në këtë qark që ishte i dyti, nuk ka mundur të marrë mandatin. Në Berat janë numëruar 305 kuti, ku PS ka marrë në total 45189 vota, PD 16067 vota dhe LSI 19529 vota. Humbjen më të madhe PD e ka marrë në zonën e Çorovodës. Pikërisht në këtë zonë, në 34 kuti votimi LSI ka dalë forcë e parë, ku ka numëruar 4295 vota, ndërsa PS 2911 dhe vetëm 419 vota ka marrë Partia Demokratike. Ndërkohë në Poliçan forcë e parë PS, ndërsa PD forcë e tretë. Ndërkohë surpriza në Kuçovë, është se edhe pse bashkia e këtij qyteti drejtohet nga LSI, kjo forcë politike është renditur e treta. Qarku i Beratit ka qënë i qetë gjatë procesit të votimit ditën e djelë. Gjatë gjithë ditës ka ndodhur vetëm një incident i vogël, ndërkohë subjektet politike të përfshira në këtë garë, thujtse nuk kanë bërë asnjë deklaratë me akuzat të ndërsjellta, duke ia lënë garës dhe votuesve fjalën e fundit. Berati njihet si zonë që gjithmonë ka fituar Partia Socialiste, ndërkohë mandate deputeti ka marrë dhe LSI. Ky qark përfshin

PS DHE LSI
 PS ka arritur të marrë katër deputetë, ku ka marrë mandatin e Blendi Klosit, Ermonela Felaj, Adnor Shameti dhe Fadil Nasufi. Ndërsa LSI ka marrë dy mandate atë të Nasip Naços dhe Gledion Rahovicës.

BIZNESMENI
 Astrit Veliaj kandidati i PD në këtë qark që ishte i dyti, nuk ka mundur të marrë mandatin. Në Berat janë numëruar 305 kuti, ku PS ka marrë në total 45189 vota, PD 16067 vota dhe LSI 19529 vota.

qytetin e Kuçovës, Urës-Vajgurore dhe Çorovodën, ku në total ka pasur 180.682 votues. Sipas të dhënave zyrtare nga KQZ 8200 janë femra që kanë votuar në këtë qark, ndërkohë pjesëmarrja në votime ka qënë 42 për qind. Procesi i votimit është hapur në orën 07:00 të mëngjesit në 305 qendrat e votimit. Gjatë procesit të votimit nuk u denoncua asnjë rast i blerjes së votave.



REZULTATET NE KOHE REALE TE QARKUT BERAT

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

| PËRDITËSIMI I FUNDIT 13:33 | | | QËNDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 305/305 | | | |
|----------------------------|--------|--------|-------------------------------------|-------|----------|------|
| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 19,529 | 23.57 | 23.49 | 2 | 1 |
| | PS | 45,189 | 54.54 | 47.38 | 4 | 6 |
| | PKD | 84 | 0.1 | 0.03 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 57 | 0.07 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 212 | 0.26 | 2.2 | 0 | 0 |
| | PD | 16,067 | 19.39 | 20.1 | 1 | 3 |
| | PBDKSH | 55 | 0.07 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 21 | 0.03 | 0.09 | 0 | 0 |
| | PSD | 65 | 0.08 | 0.2 | 0 | 0 |
| | AD | 4 | 0 | 0.04 | 0 | 0 |
| | FRD | 205 | 0.25 | 0.64 | 0 | 0 |
| | PDS | 59 | 0.07 | 0.57 | 0 | 0 |
| | PDIU | 619 | 0.75 | 0.84 | 0 | 1 |
| | AAK | 6 | 0.01 | 0.06 | 0 | 0 |
| | MEGA | 6 | 0.01 | 0.06 | 0 | 0 |
| | PKSH | 53 | 0.06 | 0.07 | 0 | 0 |
| | APD | 53 | 0.06 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 569 | 0.69 | 0 | 0 | 0 |

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU
VLORË

Pjesëmarrje e ulët, por PS konfirmohet fuqishëm në Vlorë

Tri partitë kryesore marrin më shumë
vota, socialistët fitojnë 8 mandate

Vlora është ndoshta qarku më i komplikuar nga pikëpamja elektorale në Shqipëri. Ky qark shtrihet për mbi 120 kilometra në vijë ajrore nga Konispoli deri në Brigjet e Semanit, me votues përgjithësisht të majtë, por me enklava të Ballit Kombëtar, me popullsi të konsiderueshme çame si dhe me minoritet grek. Vlora është gjithashtu qarku që ka shënuar rekorde të njëpasnjëshme pjesëmarrjeje të ulët, rezultat ky pjesërisht i migrimit masiv të popullsisë dhe pjesërisht i refuzimit për të votuar pas zhgënjimeve të njëpasnjëshme. Edhe këtë herë, pjesëmarrja ka qenë relativisht e vogël, megjithatë kjo nuk pengoi socialistët të merrnin 13.4 për qind më shumë vota se në zgjedhjet e kaluara parlamentare. Kjo u cilësua edhe nga kryeministri Edi Rama, që e kishte vënë emrin e tij të pestin në listën e kandidatëve, si një fitore e konsiderueshme. PS arriti të marrë 65.212 vota të dielën, ndërkohë që katër vjet më parë kishte marrë mbi 56 mijë vota.

Edhe dy partitë e tjera rivale, PD dhe LSI kanë rritur rezultatet, duke marrë përkatësisht 2.6 për qind më shumë dhe 2.5 për qind më shumë se katër vjet më parë, në zgjedhjet parlamentare të 2013-ës. Por mandatet janë ndarë 8 - 3 - 1.

Kjo ka bërë që vetëm Shezai Rokaj të marrë mandat si përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim. Ndërkohë që, nga kampi i demokratëve, ka patur zhvillime mjaft kurioze. Kështu, Vangjel Dule, i cili ka punuar si kandidat në Himarë dhe i përfshirë në listat e Partisë Demokratike, në Himarë ka siguruar pak vota, por gjithsesi do të vijojë të jetë përfaqësues i komunitetit grek në Kuvend, pasi PD e kishte vendosur të tretin në listë, duke penalizuar Arben Ristanin, është sekretar i përgjithshëm i PD dhe që nuk do të marrë mandatin e deputetit.



REZULTATET NE KOHE REALE
TE QARKUT VLORË

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas



KTHESAT

Kthesë është shënuar në dy zona si në Delvinë, që më parë kontrollohej nga LSI dhe në Selenicë, ku mbizotëronte Partia Demokratike më parë. Në të dy këto zona prapë mbizotëroi vota për Partinë Socialiste



MANDATET

PD dhe LSI kanë rritur rezultatet, duke marrë përkatësisht 2.6 për qind më shumë dhe 2.5 për qind më shumë se katër vjet më parë, në zgjedhjet parlamentare të 2013-ës. Por mandatet janë ndarë 8 - 3 - 1

Në bashki si Saranda, Himara apo Konispoli nuk ka patur ndryshime dhe ato do të vazhdojnë të kontrollohen nga Partia Socialiste. Por kthesë është shënuar edhe në Delvinë, që më parë kontrollohej nga LSI dhe Selenicë, ku mbizotëronte PD. Në të dy këto zona prapë mbizotëroi vota për Partinë Socialiste.

PËRDITËSIMI I FUNDIT 18:15

QËNDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 447/447

| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
|------|--------|--------|-------|-------|----------|------|
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 12,405 | 11.37 | 8.88 | 1 | 1 |
| | PS | 65,242 | 59.77 | 46.39 | 8 | 6 |
| | PKD | 804 | 0.74 | 0.05 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 149 | 0.14 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 153 | 0.14 | 0.8 | 0 | 0 |
| | PD | 22,544 | 20.65 | 18.11 | 3 | 3 |
| | PBDKSH | 236 | 0.22 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 43 | 0.04 | 0.04 | 0 | 0 |
| | PSD | 67 | 0.06 | 0.33 | 0 | 0 |
| | AD | 35 | 0.03 | 0.03 | 0 | 0 |
| | FRD | 406 | 0.37 | 1.02 | 0 | 0 |
| | PDS | 220 | 0.2 | 0.79 | 0 | 0 |
| | PDIU | 3,600 | 3.3 | 5.78 | 0 | 1 |
| | AAK | 57 | 0.05 | 0.06 | 0 | 0 |
| | MEGA | 1,941 | 1.78 | 1.61 | 0 | 0 |
| | PKSH | 66 | 0.06 | 0.02 | 0 | 0 |
| | APD | 72 | 0.07 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 1,107 | 1.01 | 0 | 0 | 0 |

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU GJIROKASTËR

Qarku Gjirokastrë mbetet majtas çfarë tregoi gara

Tritan Shehu denoncoi pa emra vjedhje votash "organizuar nga shteti"

Qarku i Gjirokastrës ka votuar në përgjithësi majtas, duke i dhënë me shumë mandate Partisë Socialiste se sa Partisë Demokratike. Më 2009, PS arriti të marrë tre mandate, ndërsa PD mori dy. Këtë herë PS rikonfirmoi sërish tre mandate, ndërkohë që PD dhe LSI ndanë nga një mandat tjetër.

Në tërësi, situata në këtë qark është shumë e paparashikueshme pasi numrit relativisht të vogël të votave të banorëve i shtohen votat e emigrantëve që kthehen për të votuar, zakonisht të organizuar nga partitë politike. Por në këto zgjedhje nuk u vërejt ndonjë lëvizje masive sa të binte në sy.

PS arriti të futë në Kuvend Bledi Çuçin dhe Mirela Kumbaron, dy ministra dhe njerëz të afërt të kryeministrit Rama. Po kështu edhe Flamur Golemin, një mjek nga Gjirokastra, kryetar i PS të Bashkisë Gjirokastrë. Ndërkohë, nga PD arriti të sigurojë vendin në Kuvend vetëm Tritan Shehu dhe mbeti jashtë kandidati që ishte vendosur në vend të dytë, Roland Bejko, pedagog me karrierë të gjatë si drejtues i Partisë Demokratike në këtë zonë.

LSI garoi dhe fitoi me deputetin e vet Vangjel Tavo, me profesion mjek, deputet jetëgjatë që nga viti 1997 dhe ish-ministër i Shëndetësisë. Ai më parë ka qenë edhe në listat e Partisë Socialiste. U vu re që në Bashkinë e Dropullit LSI arriti të dilte si forcë e parë politike në votime, falë ndikimit të tij. LSI që nga viti 2015 kontrollon edhe Bashkinë e Gjirokastrës, më e madhja në këtë qark për nga numri i votuesve.

Tritan Shehu ka denoncuar më pas publikisht atë që e cilësoi si vjedhje masive të votave. Shehu pohoi se blerja masive e votës ndryshoi rezultatit final në Gjirokastrë, ku PS-ja mori 3 deputetë, PD 1 dhe LSI 1.

PS

PS arriti të futë në Kuvend Bledi Çuçin dhe Mirela Kumbaron, ministra dhe njerëz të afërt të kryeministrit Rama. Po kështu edhe Flamur Golemin, mjek nga Gjirokastra, kryetar i PS të Bashkisë Gjirokastrë



Tritan Shehu

LSI

LSI garoi dhe fitoi me deputetin e vet Vangjel Tavo, me profesion mjek, deputet jetëgjatë që nga viti 1997 dhe ish-ministër i Shëndetësisë. Ai më parë ka qenë edhe në listat e Partisë Socialiste

"Blerja e votës ka ndryshuar rezultatit në Gjirokastrë. Ne kemi bërë thirrjet tona, por i takon policisë të hetojë".

Ndërkohë që u pyet nëse ka prova me emra, Tritan Shehu u përgjigj se "Nuk kam prova, se nuk jam prokuror. Por opinioni im është se e gjithë kjo është organizuar nga strukturat shtetërore".



REZULTATET NE KOHE REALE
TE QARKUT GJIROKASTËR

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas




PËRDITËSIMI I FUNDIT 00:18

QËNDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 235/235

| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
|------|--------|--------|-------|-------|----------|------|
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 12,545 | 23.19 | 19.14 | 1 | 1 |
| | PS | 27,215 | 50.3 | 42.74 | 3 | 6 |
| | PKD | 64 | 0.12 | 0.04 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 34 | 0.06 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 81 | 0.15 | 5.01 | 0 | 0 |
| | PD | 13,307 | 24.6 | 22.46 | 1 | 3 |
| | PBDKSH | 24 | 0.04 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 36 | 0.07 | 0 | 0 | 0 |
| | PSD | 27 | 0.05 | 0.6 | 0 | 0 |
| | AD | 6 | 0.01 | 0.14 | 0 | 0 |
| | FRD | 43 | 0.08 | 0.59 | 0 | 0 |
| | PDS | 72 | 0.13 | 0.61 | 0 | 0 |
| | PDIU | 163 | 0.3 | 0.35 | 0 | 1 |
| | AAK | 4 | 0.01 | 0.57 | 0 | 0 |
| | MEGA | 65 | 0.12 | 0.3 | 0 | 0 |
| | PKSH | 24 | 0.04 | 0.14 | 0 | 0 |
| | APD | 57 | 0.11 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 334 | 0.62 | 0 | 0 | 0 |

SHOIPËRIA VOTON
SPECIALE ZGJEDHJET
PARLAMENTARE 2017



QARKU DURRËSI

PS ruan fitoren e thellë në Durrës, merr 8 mandate


Shpërthen Agron Duka: PD inekzistente në Durrës, vetëm fitoja mandatin

Pas përfundimit të numërimit të votive asgjë nuk ka ndryshuar në Durrës. Partia Socialiste ka ruajtur fitoren e thellë, duke siguruar plot 8 mandate deputetësh. Pavarësisht se demokratët kishin pritshëmri të mëdha në Durrës, për shkak edhe të aleancave, socialistët kanë marrë dyfishin e mandateve. PD-ja arrit të marrë vetëm 4 mandate. Ndërsa Lëvizja Socialiste për Integrim ka marrë 2 mandate



REZULTATET NE KOHE REALE
TE QARKUT DURRËS

Për të parë rezultatet në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas



DEPUTETËT FITUES

Englantina Gjermani, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ilir Ndraxhi, Roland Xhelilaj, Jurgis Xhyrbja, Rrahman Rrahja, dhe Klodiana Spahiu janë tetë emrat fitues të Partisë Socialiste. Ndërsa për demokratët Oerd Bylykbashi, Fatbardha Kadiu, Edi Paloka e Florjon Mima janë fitues. Për Lëvizja Socialiste për Integrim kanë marrë 2 mandate Lefter Koka dhe Nora Malaj.



Agron Duka

DUKA: GABOVA, VETËM FITOJA MANDATIN

Rezultati i dobët i demokratëve ka dëmtuar një prej politikanëve më të vjetër të Durrësit, Agron Dukën. Kryetari i Partisë Agrare Ambientaliste, Agron Duka, ka shpërthyer në akuza ndaj Partisë Demokratike, pas humbjes së mandatit në Qarkun e Durrësit. Duka renditej i pesti në listën shumëemërore të PD, ndërsa nuk arriti të ruante mandatin, pasi e djathta mori vetëm 4 deputetë në këtë qark. Gjatë një deklarate për mediat, Duka tha se strukturat e PD në Durrës janë inekzistente, ndërsa shtoi se nëse do kandidonte i vetëm, do kishte fituar. "Këta ministrat teknikë ne besuam qenka më keq. U përdorën të fortët, paratë, pati dhunim të votuesve si dhe u përdorën paratë. Angazhim mizerabël i strukturave të PD, thujse inekzistente në Durrës. Ne u munduam të organizonim diçka por fakti që nuk ia arritëm u refuzuam dhe ndodhi kjo. Marrëveshja ime me Bashën

SHIFRAT

Partia Socialiste ka marrë 72873 vota, 49.69%. Partia Demokratike ka marrë 42488 vota, 28.97%. Lëvizja Socialiste për Integrim mori 21712 vota, 14.80%.

STRUKTURAT

Angazhim mizerabël i strukturave të PD, thujse inekzistente në Durrës. Ne u munduam të organizonim diçka por fakti që nuk ia arritëm u refuzuam dhe ndodhi kjo.

për vendet në listat e PD si në Tiranë, Durrës e Fier ishte i gabuar dhe gabimi është i imi. Pata një komunikim me Bashën i cili më tha në telefon se a mund ta marrim mandatin e pestë. i thashë që nuk ka asnjë shans. Edhe për të më vjen keq. Përgjegjësia është e të gjithëve. Po të kishim dalë vetëm, padyshim që do kishim fituar", u shpreh Duka.

PËRDITËSIMI I FUNDIT 17:28

QËNDRA VOTIMI TË NUMËRUARA: 460/460

| LOGO | PARTIA | VOTA | % | | DEPUTETE | |
|------|--------|--------|-------|-------|----------|------|
| | | | 2017 | 2013 | 2017 | 2013 |
| | LSI | 21,712 | 14.8 | 7.91 | 2 | 1 |
| | PS | 72,873 | 49.69 | 39.82 | 8 | 6 |
| | PKD | 618 | 0.42 | 0.07 | 0 | 0 |
| | SFIDA | 275 | 0.19 | 0 | 0 | 0 |
| | PR | 519 | 0.35 | 6.47 | 0 | 0 |
| | PD | 42,488 | 28.97 | 34.05 | 4 | 3 |
| | PBDKSH | 284 | 0.19 | 0 | 0 | 0 |
| | ADK | 152 | 0.1 | 0.02 | 0 | 0 |
| | PSD | 485 | 0.33 | 0.3 | 0 | 0 |
| | AD | 87 | 0.06 | 0.04 | 0 | 0 |
| | FRD | 896 | 0.61 | 2.94 | 0 | 0 |
| | PDS | 257 | 0.18 | 0.24 | 0 | 0 |
| | PDIU | 4,351 | 2.97 | 2.86 | 0 | 1 |
| | AAK | 28 | 0.02 | 0.63 | 0 | 0 |
| | MEGA | 16 | 0.01 | 0.06 | 0 | 0 |
| | PKSH | 74 | 0.05 | 0.04 | 0 | 0 |
| | APD | 57 | 0.04 | 0 | 0 | 0 |
| | LIBRA | 1,488 | 1.01 | 0 | 0 | 0 |

Policia: Garantuam qetësinë, kapën 7 vetë, 10 në kërkim

Çako jep tablonë zgjedhore. "Ndërhymë në vetëm 190 raste në disa qendra"

ELTON QYNO
TIRANE

Drejtori i Policisë së Shtetit, Haki Çako, ka bërë bilancin e punës së Policisë së Shtetit në mbarëvajtjen e zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit. Gjatë një konference për shtyp, Çako tha se policia mbuloi mbi 2000 QV në gjithë vendin. Sipas tij, fushata nuk u shoqërua me incidente, ndërsa theksoi se po hetohen nga policia 44 vepra penale të shënuara gjatë fushatës dhe ditës së votimit. Shtatë persona janë arrestuar nga policia, tha Çako si dhe janë proceduar shtatë subjekte politike për shkelje ligjore. "Në zbatim të urdhrave të ministrit të Brendshëm, lidhur me vëzhguesit e OSBE/ODIHR u sigurua mbarëvajtja e procesit. Nga strukturat e policisë së Shtetit u përballua ngarkesa e punës, duke mbuluar mbi 2000 qendra votimi. Gjatë të gjithë aktivitetëve nuk u evidentua asnjë aksident. U siguruan masat e lëvizjeve të figurave shtetërore, ndërsa nuk u konstatua asnjë incident. Janë trajtuar dhe po hetohen 44 vepra penale, nën procedim 84, 7 të arrestuar. Më konkretisht 7 procedime penale ndaj subjekteve politike. Gjatë procesit të votimit në 25 qershor po trajtohen 25 procedime, që kanë çuar zgjedhjet e lira"-tha Çako.

10 PERSONA NË KËRKIM

Ndërsa gjatë procesit të votimit të datës 25 Qershor 2017 janë trajtuar dhe po hetohen 25 procedime penale, ngjarje të dyshuara si vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve. Për këto procedime janë evidentuar 27 autorë, nga të

STATISTIKAT E PROCEDIMEVE

- 7 Procedime penale "Pengimi i subjekteve zgjedhore",
- 19 Procedime penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje",
- 4 Procedime penale "Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore", "Korrupsioni pasiv në zgjedhje", 2 vepra penale.
- 11 Procedime penale "Kanosja apo dhunim ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje",
- 1 Procedim penale "Shpërdorimi i autoritetit policor".

VEPRAT PENALE

- "Pengimi i subjekteve zgjedhore" 1 procedim penale.
- "Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve", 1 procedim penal.
- "Dëmtim me dashje i materialit zgjedhor", 1 procedim penal.
- "Shkelje e fshehtësisë së votimit", 5 procedime penale.
- "Votim me shumë se një here ose pa u identifikuar", 2 procedime penale.
- "Korrupsioni aktiv në zgjedhje" 10 procedime penale.
- "Kanosja apo dhunim ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje" 4 procedime penale.
- "Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve", 1 procedim penal.
- Janë dërguar për vlerësim në Prokurori 3 materiale procedurale.

cilët 7 janë arrestuar, 10 ndiqen në gjendje të lirë, si dhe 10 janë shpallur në kërkim. Janë dërguar për vlerësim në prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, 2 vepra penale. Gjatë gjithë periudhës zgjedhore nga data 26 Maj, deri 25 Qershor, janë evidentuar 69 vepra penale, që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të cilat janë referu-

ar në Prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe janë në hetim, proceduar penalisht 114 persona, nga të cilët 20 të arrestuar, 77 në gjendje të lirë dhe 17 në kërkim. Konstatohet fakti se veprat penale të evidentuara vetëm në datën 25 Qershor (ditën e votimit), zënë 36.2 për qind të veprave penale të ndodhura gjatë gjithë procesit zgjedhor. Gjithashtu po



Haki Çako

S'SHKARKOHEM SHEFAT

3 hetime disiplinore të nisura pas letrës së Ministrit të Punëve të Brendshme, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për tre shefa Komisaratesh, Pukë, Gramsh e Dibër, theksoj se pas verifikimeve të bëra nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, rezultoi se shefat e komisarateshve kanë kryer detyrën konform ligjit.

NJË I ARRESTUAR

Është arrestuar një punonjës policie i Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Durrës, për shkelje të depolitizimit, si dhe ka filluar hetimi disiplinor për një punonjës Policie në Komisaratin e Policisë Shkodër.

në drejtim të parandalimit dhe goditjes së shit-blerjes së votës, janë referuar edhe raste të tjera për vlerësim nga Prokuroria në disa qarqe të vendit, për individë të caktuar, simpatizantë apo përfaqësues të subjekteve elektorale. Gjatë marrjes në ruajtje dhe dorëzimit të qendrave të votimit, si dhe gjatë shoqërimit dhe dorëzimit të materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit, nuk u shënuar asnjë problem, përveç një incidenti në Vlorë, incident mes anëtarëve të komisionit, ku ndërhyrja profesionale dhe ligjore e policisë bëri të mundur ruajtjen e kutive të votimit dhe dorëzimin e tyre pa u cenuar në KZAZ, falë kësaj edhe kontributit të KZAZ-së në zgjedhjen e situatës.

NË 190 RASTE NDËRHYRI POLICIA

Gjithashtu gjatë procesit të votimit është kërkuar ndërhyrja e Policisë në 190, raste në të gjithë

vendin, ku Policia me Vendim të Komisioneve përkatëse ka ndërhyrë në 72 raste, pasi rastet e tjera janë zgjidhur vetë nga komisionerët pa qenë nevoja e ndërhyrjes së Policisë. Për sa i përket numërimit të votave, nga KZAZ-të është kërkuar ndërhyrja e policisë në 3 raste për të nxjerrë personat e pa autorizuar në VNV, ku policia me vendim të KZAZ-së ka ndërhyrë në 3 raste në VNV-të. Ndërhyrjet e Policisë qoftë në QV, apo në VNV, kanë qenë profesionale dhe nuk ka pasur asnjë problem gjatë kryerjes së detyrës për problematikën e kërkuar për zgjedhje nga policia. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit u kërkuar dhe u ndoq me vëmendje që të gjithë punonjësit e policisë në strukturat qendrore dhe vendore të ushtronin të drejtën e votimit, me gjithë ngarkesën e punës dhe vështirësitë në këtë drejtim për shkak të shërbimit.

NË NJËSINË TONIN

Dibër, dhunoi gruan, arrestohet 24-vjeçari

Policia e Dibrës ka arrestuar një 27 vjeçarë Klevis V, pasi është akuzuar nga bashkëshortja e tij B.V., se ka ushtruar dhunë fizike mbi të. Sipas policisë bashkëshortja e tij, banuese në njësinë Tonin-Dibër, e ka akuzuar atë se për motive të dobëta, bashkëshorti i saj ka tentuar ta nxjerrë jashtë shtëpisë së tyre, duke ushtruar dhunë fizike ndaj saj. Materialet hetimore i kaluan Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Dibër, për veprën penale "Dhunë në familje".

NGJARJANË DËRRËS

Sherr me thika mes të rinjve, plagoset 25 vjeçari



Një sherr me thika ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në qytetin e Durrësit, ku sipas policisë, 26 vjeçari Andrea Shahaj, ka tentuar të vrasë me thikë, 25-vjeçarin E.B. Policia ka ndërhyrë duke bërë të mundur arrestimin e menjëhershëm Andrea Shahaj, ndërkohë që E.B ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Sherr ka ndodhur për motive të dobta, dhe në cilësinë e provës materiale është sekuestruar thika. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprat penale "Vrasja me dashje" e mbetur në tentativë dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta".

ÇËSHTJA E DROGËS

U dënua me 2 vite burg lirohet nga qelia Ben Çami

Kur kanë kaluar 1 vit e 5 muaj në qeli, Lutfi Shabani ose siç njihet ndryshe "Ben Çami" është liruar nga qelia. Vendimi është marrë nga Gjykata e Krimeve të Rënda e cila dënoi Shabanin me 2 vite burgim për akuzën e "Moskallëzimit të krimit". Duhet theksuar se Shabani u arrestua në muajin Shkurt 2016, për akuzën e "Trafikimit të lëndëve narko-

tike" kryer në bashkëpunim, e mbetur kjo në tentativë. Më të njëjtën akuzë, Lutfi Shabani ka shkuar në gjykatë si i pandehur por në séancat e para gjyqësore, prokuroria vendosi të ndryshojë këtë akuzë, duke e akuzuar përfundimisht Shabanin për veprën penale të "Moskallëzimit të krimit". Për këtë veprë penale Shabani fillimisht u dënua me 3 vjet heqje lirie,

ndërkohë duke aplikuar gjykimin e shkurtuar, masa e dënimit ulet me një të tretën dhe si pasojë, i pandehuri Lutfi Shabani është dënua përfundimisht me dy vjet burgim. Ky vendim është marrë në 30 maj të këtij viti, por për shkak se Shabani ka plotësuar periudhën e dënimit, ai është liruar nga qelia. Lutfi Shabani i njohur si Ben Çami është dënua vite

më parë si një ndër organizatorët kryesorë të trafikut të heroinës nga Turqia në Shqipëri e mandej vendet e BE. Ndërkohë në këtë dosje ai dyshohej se në bashkëpunim me Eldi Zahiri dhe Janaq Kaceli, kishin tentuar të trafikonin 574 kg drogë nga pika e kalimit kufitar të Kapshticës. Eldi Zahiri është dënua nga gjykata e Krimeve të Rënda me 8 vjet heqje lirie.



Lutfi Shabani

FJALËKRYQESH

NGA **KADRI VOKOPOLA**



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI **34** KUTI

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 |
| 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 8 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 9 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 11 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 12 | | | | | | | | | | | | | | | | | |

HORIZONTAL

- Lodra pa zë.
-Qenë dënuar të mbushin një fuçi pa fund.
-Marple e Agatha Christie
- Inicialet e Reitman.
-Jack që shkroi On the road.
-Film i Akira Kurosawa-s.
- I kanë pa kapakë ata që flasin troç.
-Në krye të bashkisë.
-Fillojnë daljen.
- Një pije para ngjënies.
-The... film i Clark Johnson.
- Eshtë halli
-Emër burri.
- Drekuar pa duar.
-Qe një nga muzat.
- Mund të jetë emërore.
-U paraprinë nga manufakturat.
-Fillojnë ndeshjen.
- Varen në dritare.
-Zanore kateti.
-Me të bëjnë një litër.
- Ishte shesh i akejve.
-Martin regjisor.
-Eshtë edhe ai dallues
- Një pikë në kontratë.
-Eshtë shkronjë.
-Janë për të mbështjellë foshnjat.
- Toska këngëtare popullore.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| S | T | A | R | T | I | L | O | R | I | K | F | A | S | | | |
| T | E | R | R | I | T | O | R | R | O | S | L | P | | | | |
| U | R | I | M | E | N | O | T | N | E | S | T | O | R | I | | |
| L | I | M | A | T | B | E | S | I | M | T | A | R | E | T | | |
| L | A | I | R | E | V | O | L | U | C | I | O | N | A | R | E | A |
| A | P | R | E | T | A | P | O | R | T | E | R | L | | | | |
| P | O | L | I | S | T | I | R | O | L | I | I | T | E | | | |
| S | I | R | I | I | R | E | Z | E | U | D | I | T | | | | |
| U | R | A | T | T | I | M | I | I | N | D | E | T | | | | |
| P | A | R | A | F | I | N | A | M | A | L | I | V | A | L | | |
| E | T | E | R | I | A | T | L | E | T | I | K | A | N | E | | |
| R | I | T | E | T | T | A | R | T | A | R | E | T | E | K | | |

- Eshtë për të prashitur.
- 12. I ka tek treni
- Gabim rrjete në tenis.
- Janë telefilla.
- VERTIKAL**
- 1. Janë pemë me lende.
- Ishin litarë të Tarzanit.
- 2. Ishte me çekan në flamurin e BRSS.
- Richard aktor.
- 3. Tani quhet Dardanele.
- Janë shpendë që bëjnë kra-kra
- Fillojnë hetimet.
- 5. Emri i Diderot.
- Louis poet surrealist.
- 6. Franklin këngëtare.
- Pak elementare.
- 7. Eshë sport me stil të lirë.
- Janë plot gjemba
- 8. Në krye të autoriteteve.
- Një detyrim që paguhet.
- 9. Fleming që krijoi James Bond.
- Komision Ekonomik Berat.
- Njofonte nga BRSS.
- 10. Daci kur s'është ai.
- Janë shpendë që bëjnë kra-kra
- Fillojnë hetimet.
- 11. Smith që qe këngëtare.
- Një pjesë e parlamentit.
- 12. Përfshin botën e vjetër.
- 13. Përplasen me gatiu të tilla.
- Emër burri.
- 14. Një linjë e famshme mbrojtëse.
- Inicialet e Eluard.
- 15. Mbyllin kuvendin.
- Nderi pa zanore.
- Jessica aktore.
- 16. Ishte vajza e famshme e Alteas.
- 17. Falen pa fe.
- Hidhet një për të zbardhur m\$isterin.

FJALËKRYQI SPORTIV

| | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| | 2 | | | 3 | | 4 | | 5 | 6 | 7 | |
| 8 | | 9 | | 10 | | 11 | 12 | 13 | | 14 | |
| | | 15 | | 16 | | | | | 17 | | |
| | | 18 | | | | | | 19 | 20 | | |
| 21 | 22 | | | | | | | 23 | | 24 | 25 |
| 26 | | 27 | | | 28 | | | 29 | 30 | | |
| 31 | | | 32 | | | | | 33 | | | |
| 34 | | | 35 | | 36 | | 37 | | | | |
| | | | 38 | | 39 | | 40 | | 41 | 42 | 43 |
| | | | 44 | | | | | | | | |

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| L | A | T | M | S | M | A | R | I | O | | | | | |
| E | A | L | A | I | N | P | A | R | A | | | | | |
| O | F | A | T | O | S | M | U | C | O | V | | | | |
| N | E | V | E | R | T | O | N | L | U | I | S | | | |
| E | S | D | E | P | R | E | S | I | O | N | I | L | N | I |
| D | I | N | O | E | I | S | N | E | M | O | S | E | R | |
| M | E | A | N | D | O | N | I | | | | | | | |
| N | O | T | I | | | | S | H | U | K | | | | |
| E | N | | E | L | I | S | B | A | K | A | J | | | |
| M | A | R | I | O | M | A | N | D | Z | U | K | I | C | |

HORIZONTAL

- Mbyllin një takim
- Kush nuk ka.... nuk i ecën.
- Gjysmë milion.
- Eshtë i madh ndërmjet skuadrave në një derby.
- Ishte Teuta kur ishte në... binarë.
- Diftong në dietë.
- Janë armë precizioni.
- Klub Sportiv.
- Janë gjërat e mërzitshme.
- Villa në kampionatin anglez.
- Emri i Tyson.
- Beton pa kufij
- Dybala te Juventus.
- Sastre aktore.
- Nisin nga kreu.
- Eshtë llojtari i under 21.
- Një pjesë për aktor
- Mbyllin portet.
- Personazhi në foto.
- Personazhi në foto.

VERTIKAL

- Mbyllin një takim.
- Një derby i "Madonna-s".
- Michael regjisor.
- Ullmann aktore
- Santa në New Mexico.
- Eshtë baba.
- Me break në tenis.
- I paharruari Borici.
- Eshtë automë.
- Më mirë se kurrë.
- Ai dhe ajo
- Pak literaturë
- Eshtë detyrim që paguhet.
- Winslet aktore.
- Një sigël që tremb boksierin.
- Një pjesë e studimeve
- Zoff, ish-portier.
- Një qendër.
- Hapin pa kufij.
- Mbyllin një simbol.
- Në krye të notarëve.
- Josa trainer.
- Emri i marubit.
- Fundi i një filmi.
- Tase e volejbollit.
- Beson pa kufij
- Koço dirigjent.
- Inicialet e Morata-s
- 11 romake.
- Inicialet e Gilardino-s.
- Digjet në skaje.
- Inicialet e Zemeckis.
- Diftong poetik

SUDOKU

LOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1-9

PËRGJIGJE

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 2 | 3 | 6 | 9 | 4 | 8 | 7 | 1 |
| 9 | 7 | 4 | 2 | 8 | 1 | 3 | 6 | 5 |
| 8 | 1 | 6 | 7 | 3 | 5 | 2 | 4 | 9 |
| 1 | 8 | 5 | 3 | 6 | 2 | 7 | 9 | 4 |
| 2 | 3 | 7 | 4 | 5 | 9 | 1 | 8 | 6 |
| 4 | 6 | 9 | 8 | 1 | 7 | 5 | 2 | 3 |
| 6 | 9 | 8 | 5 | 2 | 3 | 4 | 1 | 7 |
| 3 | 4 | 1 | 9 | 7 | 8 | 6 | 5 | 2 |
| 7 | 5 | 2 | 1 | 4 | 6 | 9 | 3 | 8 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 7 | | 4 | | 9 | | | 1 | |
| | | | 3 | | 5 | | | | |
| 6 | | | 8 | 1 | 2 | | | | 3 |
| | 6 | 7 | | 8 | | 9 | 4 | | |
| | | | | 5 | 4 | 6 | | | |
| 1 | 4 | 3 | | | | | 5 | 6 | 8 |
| | | 5 | | | | | 4 | | |
| 8 | 3 | | 7 | 2 | 4 | | | 5 | 9 |
| 4 | | 9 | | | | | 2 | | 7 |

HOROSKOPI

DASHI



Ditë përgjithësisht e bukur dhe me diell kjo e sotmja për të dashuruarit. Do kuptoheni mirë me njeri-tjetrin dhe nuk do keni konflikte. Ata që kanë qenë larg njeri-tjetrit do kenë takime pasionante. Beqarët do dëshirojnë të qëndrojnë vetëm për të reflektuar mbi të ardhmen. Financat duhet t'i administroni me kujdes.

LUANI



Entuziazmi dhe emocionet do e pushtojnë sot jetën sentimentale të çifteve. Do kuptoheni më së miri me atë që keni në krah dhe do i zgjidhni keqkuptimet e vogla që kishit pasur. Beqarët do kenë takime të shumta, por asnjëri nuk do ua mbushë mendjen sa për të filluar një lidhje.

SHIGJETARI



Jeta juaj në çift do ketë një rëndësi shumë të madhe gjatë kësaj dite. Do i kushtoni kohën e duhur parterit/es dhe do mundoheni me çdo kusht t'i zgjidhni mosmarrëveshjet që keni pasur. Beqarët jo vetëm që do kenë takime, por do gjejnë një person i cili do jetë fiks si ata e kishin ëndërruar. Për të ruajtur qëndrueshmërinë financiare nuk duhet të shpenzoni pa u menduar.

DEMI



Ndikimi i yjeve nuk do jetë shumë pozitiv për jetën sentimentale të çifteve. Do keni shumë dyshime mbi partnerin/en dhe herë pas here do bëni skena xhelozie. Beqarët me shumë gjasa do e bëjnë për vete personin që pëlqejnë dhe do futen në një etape të re. Sektori i financave do jetë i qetë. Nuk do ketë probleme.

VIRGJËRESHA



Edhe nëse keni debate të forta me partnerin/en tuaj nuk duhet të tregoheni pesimistë. Në një lidhje janë normale debatet, por duhet të dini si t'i zgjidhni ato me kujdes dhe diplomaci. Beqarët me shumë gjasa do e gjejnë personin ideal dhe do ndihen më të qetë.

BRICJAPI



Do keni shumë mosmarrëveshje sot me atë që keni në krah dhe kjo do i merrzitet pa masë. Asnjëri prej jush nuk do tolerojë dhe kjo do e vështirësojë situatën. Beqarët nuk duhet të pranojnë çdo lloj ftese që do iu bëhet sepse mund të lëndohen. Sektori i financave do jetë mjaft i qëndrueshëm. Shfrytëzoni për të kryer investimet e duhura.

BINJAKËT



Ditë mjaft e turbullt kjo e sotmja për jetën sentimentale të çifteve. As vetë nuk do jenë të qartë për atë që doni dhe do konfliktoheni gjithë kohës me atë që keni në krah. Për beqarët dita do jetë më pozitive. Do ia kaloni mirë me miqtë tuaj dhe do takoni disa persona të rinj e mjaft interesantë.

PESHORJA



Ka rrezik që jeta juaj në çift të jetë mjaft e trazuar gjatë kësaj dite. Do keni debate të forta me njeri-tjetrin dhe do jeni gjithë kohës të mërzitur. Beqarët duhet të dalin sa më shumë që të mundin në mënyrë që të takojnë persona të shumtë. Financat do jenë të mbrojtura, por kjo nuk do të thotë që ju të shpenzoni sa të dëshironi.

UJORI



Nëse ka disa gjëra që nuk i pëlqejnë tek ai që keni në krah është më mirë t'ia thonit. Mos e shtyni për më vonë sepse do iu mblidhen edhe më tepër pakënaqësi. Beqarët do jenë sharmantë, por do kenë mundësi vetëm për aventura kalimtare. Financat do fillojnë të përmirësohen pak nga pak. Vazhdoni të tregoheni sa më të matur dhe të kujdesshëm.

GAFORRJA



Konfigurimi i yjeve do jetë mjaft i mirë për jetën tuaj sentimentale sot. Ata që kanë shumë kohë bashkë do mendojnë për një bashkëjetesë ose për një fejesë. Beqarët do jenë gjithë kohës në kërkim, por nuk kanë për ta gjetur personin që kanë ëndërruar. Në planin financiar do kryeni transaksione me rëndësi dhe situata do përmirësohet ndjeshëm.

AKREPI



Do i shprehni edhe më shumë ndjenjat sot për të dashurin tuaj të zemrës dhe çdo gjë do shkojë më së miri ndërmjet jush. Beqarët jo vetëm që do kenë takime interesante, por do mund të fillojnë edhe angazhime serioze. Situata financiare do konsolidohet mjaft dhe ju do keni mundësi të bëni ndonjë shpenzim më tepër.

PESHQIT



Asnjë planet nuk do ndikojë drejtpërdrejt në jetën sentimentale të çifteve. Duhet të tregoheni paksa më të organizuar dhe të mendoheni mirë para se të flisni. Për beqarët ndikimi i planetëve do jetë mjaft pozitiv. Ka shumë gjasa ta bëni për vete personin që pëlqeni prej kohësh. Financat nuk do jenë të favorizuara.

PËRGJIGJE

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| H | E | S | A | P | A | T | A | O | T | A | |
| L | L | O | I | R | A | M | J | E | T | | |
| G | I | N | S | N | N | V | A | R | J | | |
| O | A | S | H | T | E | T | E | Z | I | M | E |
| L | L | I | T | E | R | A | T | U | R | E | |
| M | I | N | E | R | A | L | E | T | T | G | |
| K | A | L | O | R | E | S | I | T | D | E | J |
| S | A | D | I | S | T | I | N | T | E | | |
| P | K | I | M | I | S | M | E | T | M | | |
| L | A | M | S | T | O | A | E | D | I | | |
| A | R | I | A | N | E | T | A | K | I | M | |
| K | A | N | T | I | N | A | T | H | A | P | I |

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

| | | | | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|---|----|----|----|----|----|----|----|----|
| 1 | P | 8 | L | 10 | 14 | T | | 15 | 5 | 16 | | 4 | | |
| 2 | | | 17 | 5 | 3 | 5 | 14 | 7 | 4 | 5 | 14 | | | |
| 3 | 9 | | | 17 | 5 | 4 | 2 | 14 | 12 | 10 | 15 | 2 | | |
| 2 | | | 4 | 12 | 10 | 7 | 14 | 5 | 14 | 7 | | | 5 | |
| 4 | 2 | 8 | 8 | 2 | 10 | | | 9 | 5 | 9 | 7 | 12 | 11 | |
| 2 | 1 | | | 8 | 3 | 7 | | 7 | 9 | 17 | 13 | 8 | 8 | |
| 8 | 2 | | | 2 | 16 | | | | | | | | | |
| 7 | 3 | | | | | | | 14 | 7 | 2 | 3 | 2 | | |
| 10 | 2 | 14 | | | 5 | | | 8 | 5 | 5 | 18 | 9 | | 7 |
| 7 | 14 | 2 | | | | 4 | 5 | 18 | | 5 | 14 | | 16 | |
| | 5 | | 4 | 3 | 7 | 1 | 5 | | 1 | 5 | 1 | 5 | | |
| 9 | 14 | 12 | 1 | | | 1 | 7 | 11 | | | 1 | 3 | 7 | 11 |

NA VIZITONI



BUNK'ART 2

**EKSPOZITA VIDEO-MUZEALE BREDA ISH-BUNKERIT
ANTI-BËRTHAMOR I MINISTRISË SË BRENDSHME**

www.bunkart.al / info@bunkart.al

**HAPUR ÇDO DITË:
10:00 deri 20:00**



**Prenotime:
+355 (0) 67 20 72 905**

**RR. "ABDI TOPTANI"
PRANË MINISTRISË
SË BRENDSHME-TIRANË**

